



RAPORTI VJETOR
2019



1

MESAZH NGA DREJTORI
I PËRGJITHSHËM

2

DIVIZIONI I
ZHVILLIMIT TË BIZNESIT

3

DIVIZIONI
RISKUT

4

DIVIZIONI
OPERACIONAL

5

KËSHILLI
DREJTUES

6

PROJEKTET

7

BURIMET
NJERËZORE

8

PËRGJEGJËSIA
SOCIALE

9

QEVERISJA
KORPORATIVE

10

RAPORTI
I AUDITORËVE

NE FLASIM GJUHËN TUAJ!

MESAZH NGA DREJTORI I PËRGJITHSHËM



MALTIN KORKUTI DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Viti 2019 u mbyll me një performancë të kënaqshme duke përmbushur me sukses objektivat strategjike të bankës. Pavarësisht sfidave të vazhdueshme të hasura përgjatë vitit të lidhura me situatën e përgjithshme ekonomike globale, ndryshimet në rritje të kërkesës rregullatore, luhatjet e kurseve të këmbimit, proceset e konsolidimit të sistemit bankar, si dhe tërmetin që preku vendin në fundvit, Credins Bank arriti të ruajë me sukses një pozicion të shëndetshëm të likuiditetit, kredisë me probleme, rritje të të ardhurave, dhe konsolidim të kënaqshëm të marrëdhënieve me klientet.

Përgjatë 2019, afirmuam pozicionin tonë si banka e parë në treg për totalin e portofolit neto të kredisë me një vlerë prej EUR 825.6 Milion si një tregues i mbështetjes së vazhdueshme që i japim bizneseve, individëve dhe ekonomisë së vendit, e cila erdhi si rezultat i një drejtimi strategjik mjaft të suksesshëm të ndjekur nga drejtuesit e bankës.

Prioriteti i bankës dhe i njesisë së zhvillimit të biznesit ka qënë mbështetja e vazhdueshme e bizneseve të vogla dhe të mesme si shtylla kryesore e zhvillimit të ekonomisë së vendit dhe rritjes së punësimit. Për ti mundësuar biznesit të vogël akses në financime, krijuam skema lehtësuese me partnerë ndërkombëtarë siç është marrëveshja COSME me Fondin Europian të Investimeve, si dhe krijimi i paketave specifike për këtë segment klientësh për të siguruar një “one stop shop” për çdo klient. Bashkëpunuam dhe mbështetëm Agrobiznesin si një nga sektorët me prioritare dhe strategjike në vend duke qënë të pranishëm në çdo skaj të vendit dhe aty ku nuk ka prezencë bankash, nëpërmjet bankës lëvizëse, një nga shërbimet më inovative të tregut vendas. Krijuam paketa të personalizuara për çdo grup klientësh duke adresuar nevojat e tyre specifike me shërbime bankare dhe komisione preferenciale siç janë paketat për studentët, bizneset e vogla, klientët agro, etj.

Lançuam fushata marketingu sensibilizuese për të ndihmuar reduktimin e informalitetit nëpërmjet rritjes së pagesave me kartat bankare duke ofruar skema besnikërie me partnerë lokalë e ndërkombëtarë, promovuam në mënyrë të vazhdueshme përdorimin dhe avantazhet e aplikacionit Credins Online. Forcuam prezencën tonë në marketingun digjital duke rritur aplikimet online për

shumë shërbime dhe produkte bankare. Transformimi i vazhdueshëm teknologjik ka qënë prioritet, i cili u konkretizua nëpërmjet modernizimit të aplikacionit mobile në një version më të bukur e të thjeshtë për çdo përdorues dhe ngritjen e strukturave të dedikuara për të ofruar 24/7 shërbim të specializuar.

Programi “YOUARECREDINS” që u lançua në fillim të vitit është shndërruar në një akademi edukimi dhe punësimi të talenteve të reja si një mundësi e shkëlqyer për të nisur karrierën e tyre dhe sot Credins Bank renditet një nga punëdhënësit më të mëdhenj në vend me 920 profesionistë, të cilët janë në fokus të një zhvillimi të vazhdueshëm nëpërmjet trajnimeve nga ekspertë të vendit dhe të huaj duke ndihmuar zhvillimin e tyre në karriere si forca shtytëse për një shërbim sa më profesional ndaj klienteve.

Të gjitha këto reflektuan një performancë pozitive kundrejt 2018 duke reflektuar një rritje në treguesit kryesorë të depozitave, aktivëve të bankës, numrit të klientëve, volumit të pagesave, apo përdorimit të kartave bankare etj. Credins Bank vazhdon të ruajë pozicionimin në treg si banka e tretë përse i takon totalit të depozitave dhe asetëve. Këto arritje i dedikohen padiskutim dhe shërbimit të shkëlqyer të ofruar në të gjitha degët tona nga stafet e bankës si dhe komoditetit që çdo klient gjen në degë kombinuar me një infrastrukturë dhe teknologji moderne.

Portofoli i kredisë korporative u rrit në mënyrë të kujdesshme duke mbështetur klientët ekzistues dhe ata të rinj të cilët prezantuan plane investimi të suksesshme, gjithmonë duke respektuar parametrat e riskut për të gjithë sektorët ku banka ka prioritetet përkatëse për t’u zhvilluar, shoqëruar kjo me një rritje të portofolit të kredisë retail si prioritet startegjik i bankës. Rritje mjaft të madhe pati portofoli i depozitave, një tregues i rendësishëm i besueshmërisë shumëvjeçare që klientët kanë ndërtuar me bankën Credins.

Një sukses i 2019 ishte edhe liçencimi i Bankës Credins nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare për ushtrimin e aktivitetit të depozitarit të sipërmarrjeve të investimeve kolektive dhe fondeve të pensionit si dhe ngritja e

infrastrukturës optimale për ushtrimin e këtij aktiviteti që do lançohet gjatë vitit 2020.

Gjithashtu, një ekperiencë mjaft pozitive ishte zgjerimi i portofolit të produkteve duke ofruar tregtimin e Eurobondit Shqiptar në tregun sekondar vendas si dhe tregtimi i letrave me vlerë në të gjithë rrejetin e degëve për çdo klient.

Do vazhdojmë të implementojmë prioritetet e përcaktuara në Planin Strategjik, duke zhvilluar ambicjet për të ecur sipas standarteve më të mira ndërkombëtare të cilat konsistojnë në përmirësime të vazhdueshme të teknologjisë, implementim të aplikacioneve moderne, zhvillim të produkteve inovative në përshtatje me ndryshimet e sjelljes së konsumatorit, zgjerim përtej kufijve të vendit në tregun e Kosovës, si dhe investime të vazhdueshme tek burimet njerëzore.

Credins vazhdon me prioritet maksimal kontributin e tij në fushën e përgjegjësisë sociale ku nëpërmjet donacioneve dhe sponsorizimeve të ndryshme, synon të ndihmojë në zhvillimin e përgjithshëm të shoqërisë, infrastrukturës, artit, kulturës, arsimit, inovacionit etj. Iniciativat e vazhdueshme të ndërmarrja vazhdojnë ta rendisin Credins Bank si një nga mbështetësit kryesor të zhvillimit të shoqërisë. Përgjatë 2019, kemi mbështetur mbi 70 iniciativa në linjë dhe me 17 objektivat për një zhvillim të qendrueshëm të OKB. Kemi bashkëpunuar me organizata dhe projekte të ndryshme që ndihmojnë në eliminimin e varfërisë për shtresat në nevojë dhe për fëmijet pa përkujdesje prindërore, mbështetjen e bizneseve start up në Shqipëri, përmirësim të infrastrukturës së shkollave dhe qendrave shëndetësore, projekte për përmirësimin e mjedisit etj.

Credins Bank do vazhdojë të kontribuojë më shumë për të gjitha shtyllat kryesore që ndikojnë në zhvillim dhe mirëqenie të përgjithshme të vendit dhe qytetarëve pasi vetëm së bashku mund të krijojmë një të ardhme më të mirë për vete, fëmijet dhe pasardhësit tanë. Në linjë me këtë, jemi duke punuar për një projekt tjetër mjaft inovativ, siç është krijimi i një platforme për mbledhje të fondeve nga publiku për të sensibilizuar gjithë shoqërinë për të kontribuar bashkarisht për një të ardhme më të mirë.

KULLA E SAHATIT TË TIRANËS


Kulla e Sahatit të Tiranës ndërtuar nga Haxhi Et'hem Beu në vitin 1822. E lartë 35 m, me hapësirë ballkoni, të montuar 4 fusha orësh me akrepa dhe një çati e tipit venecian. Deri në vitin 1970 ka qenë ndërtesa më e lartë e kryeqytetit.



DIVIZIONI I ZHVILLIMIT TË BIZNESIT

DEPARTAMENTI I BIZNESIT TË MADH

Strategjia dhe fokusi i bankës në drejtim të vogël, mikro, agro dhe individ, nuk ka lënë mënjanë mbështetjen ndaj biznesit të madh i cili është trajtuar me kujdes në kreditime cilësore si dhe duke i mbështetur në drejtim të një mirëmenaxhimi të likuiditetit të tyre, çfarë ka ndikuar dhe në rritjen e cilësisë së portofolit të kredive të këtij sektori. Segmenti i biznesit të mesëm vijon të marrë një mbështetje të vazhdueshme nga banka dhe performanca e tij ka shënuar rritje konsistente duke zënë 31.2% të totalit të portofolit të kredisë në bankë. Vlen për t'u theksuar që



kjo rritje është shoqëruar me një menaxhim mjaft të mirë të portofolit aktual duke reduktuar kreditë me probleme me 2% përkundrejt 2018. Banka Credins ka vazhduar strategjinë e lancuar për të mbështetur me financim bizneset e vogla dhe të mesme si shtylla kryesore e zhvillimit dhe punësimit në vend, ndaj portofoli korporativ pati rritje më të ngadaltë, duke reduktuar peshën e tij ndaj totalit të portofolit të bankës. Fokusi përgjatë 2019 ishte mbajtja nën kontroll e cilësisë së këtij portofoli përkundrejt sfidave të vazhdueshme të hasura përgjatë vitit të cilat u intensifikuan më shumë në fund të 2019.

Gjithashtu, përgjatë 2019 u fokusuam në rritjen e bashkëpunimit me të gjithë klientët korporativë për sa i takon përdorimit nga ana e tyre të të gjitha shërbimeve bankare duke ofruar një shërbim mjaft cilësor dhe të personalizuar. Qëllimi ynë është të jemi banka e parë për çdo klient korporativ duke ofruar shumëllojshmëri produktesh dhe ndërtuar marrëdhënie sa më afatgjatë dhe të ngushta.

Në përgjithësi u realizua një rritje e kënaqshme e volumit të biznesit, si transfertat u rritën me 9.7%, këmbimet me 6.6%, pagatorët me 11.5% dhe trasaksionet në POS me 50%. Edhe përgjatë 2020, Banka Credins ka si objektiv të mbështesë klientët ekzistues për nevojat e caktuara që mund të kenë, duke rritur në mënyrë të kujdesshme portofolin me financime të mëdha në linjë me sektoret strategjike në vend si shëndetësia, energjitika etj, por duke ruajtur cilësinë e këtij portofoli dhe duke u fokusuar në një shërbim më gjithëpërfshirës për çdo nevojë dhe shërbim të ri financiar që bizneseve mund t'u nevojitet.

DEPARTAMENTI I MENAXHIMIT TË SHITJEVE NË DEGË

Viti 2019 shënoi vitin e tretë rradhazi në implementimin e sukseshëm të projektit të “Rritjes së efikasitetit të forcës shitëse” në të gjithë rrjetin e degëve të bankës Credins. Produktiviteti i degëve i cili matet si numër i produkteve të shitura për staf shitës në degë, ka shënuar rritje edhe përgjatë 2019, duke u shoqëruar edhe me rritje të indikatorit të numrit të produkteve të shitura për klient. Produktet në fokus të forcës shitëse në çdo degë kanë vazhduar të jenë depozitat dhe kredia, pa u larguar edhe nga produktet alternative dhe përmbushëse të të gjitha nevojave financiare të klientëve. Portofoli i kredisë i gjeneruar nga rrjeti i degëve ka vazhduar rritjen në segmentin retail sidomos në kreditë e dhëna për biznesin e vogël. Portofoli i kredisë retail në 2019 është rritur me 3.88 miliard lekë ose 13.3% krahasuar me 2018. Gjatë 2019, objektivat e bankës për rrjetin e degëve u realizuan në tërësinë e tyre si përsa i përket numrave dhe volumeve, ashtu edhe për cilësinë e produkteve të shitura. Performanca e rrjetit të degëve u realizua në nivelin prej 98% referuar objektivave sasiorë dhe cilësorë të produkteve të shitura në 2019 përkundrejt një arritje prej 87% që rezultonte në 2018. Komisionet e gjeneruara nga trasaksionet bankare shënuan rritje me rreth 15% në 2019 krahasuar me vitin e kaluar, rritje e cila është realizuar në të gjithë rajonet e bankës. Këto të ardhura rezultojnë kryesisht nga komisionet e gjeneruara nga trasaksionet në POS-et, përdorimi i kartave bankare, rritje në numer dhe

volum i transfertave, këmbimeve valutore etj. Viti 2019 ishte edhe viti i risive teknologjike dhe zhvillimeve dixhitale për rrjetin e degëve, si përsa i përket vazhdimin të ristrukturimit dhe modernizimit të një numri të madh degësh, inovacionit të krijuar nëpërmjet një banke lëvizëse duke ofruar shërbimet tona bankare anëmbanë vendit dhe në zonat rurale ku mungojnë degët e bankave. Credins Online, aplikacioni i bankës “virtuale” ku mund të kryhen pothuajse të gjitha veprimet që kryhen edhe në sportelet e bankës, tregoi një sukses të madh si në shitje ashtu edhe në përdorim. Gjatë 2020 prioritetet strategjike për rrjetin e aktivitetit të degëve mbeten: ruajtja e avantazhit konkurrues të cilësisë së lartë të shërbimit ndaj klientelës, vazhdimi i automatizimit të proceseve manuale në degë i cili vitin e kaluar shënoi përmirësim të ndjeshëm, shtrirje e dixhitalizimit në degë të tjera të bankës, zhvillimi dhe përmirësimi i përdorimit të platformës Credins Online ku klientë të segment moshave të ndryshme të ndihni në të gjithë komod në shërbimet e tyre bankare si në degët tradicionale të bankës ashtu edhe në degën online. Gjithshtu, për herë të parë po finalizohet projekti për hapjen e degës “Smart”, një degë me pajisje teknologjike të fundit e cila mundëson shërbimin e klientin në 360 gradë, si fizikisht ashtu edhe online.

DEPARTAMENTI MARKETING

Departamenti marketing finalizoi një vit mjaft të suksesshëm si përsa i përket fushatave të produkteve të lancuara ashtu dhe strategjisë digjitale të ndjekur me objektiv final fuqizimin e brandit të bankës, imazhin pozitiv të përcjellë tek klientët për shumëllojshmëri produktesh dhe cilësi shërbimi si dhe kapjen e objektivave strategjike për njësinë e biznesit. Përgjatë 2019, pati një rivitalizim pjesë e strategjisë digjitale, ku u dedikua mjaft kohë dhe energji për të kapur një prezencë maksimale ndjekësish në rrjetet sociale si dhe për të rritur shitjet nëpërmjet aplikimeve online. U inicuan dy fushata në Google dedikuar Kredisë Verore dhe Kredisë Festive, të cilat gjeneruan një numër të konsiderueshëm aplikimesh online, duke vendosur një linjë komunikimi të shpejtë dhe të thjeshtë me klientët e interesuar. Si rezultat i shtimit të bashkëpunimit më të gjitha portalet në versionin mobile, u shtua me mbi 20,000 numri i klientëve që vizituan në muaj faqen tonë të webit duke e çuar në mbi 62,000 totalin, si dhe u gjeneruan gjithashtu mjaft aplikime online nga këto kanale. Viti 2019 u shoqërua me një slogan të ri “Sigurisht bëhet” duke trasmetuar mesazhe pozitive tek klientët për potencialin e bashkëpunimit me bankën Credins. Si rezultat i gjithë fushatave të lancuara në rrjetet sociale, pati një rritje mjaft të madhe numri i ndjekësve (+20,000 në '19 vs 4,800 në '18) si dhe totali i shikueshmërisë së produkteve duke kapercyer në Facebook shifren e mbi 2 Milion në '19 përkundrejt 350K në '18. U pozicionuam një nga 3 bankat

U shtua me mbi 20,000 numri i klientëve që vizituan në muaj faqen tonë të webit duke e çuar në mbi 62,000 totalin, si dhe u gjeneruan gjithashtu mjaft aplikime online nga këto kanale.

kryesore për numrin e ndjekësve në Facebook. U lancuan gjithashtu kanale të reja komunikimi me klientët për të promovuar produkte dhe shërbime si: email marketing, mas sms, etj. Në 2019, u lancua website i ri i bankës, më modern në design dhe më i lehtë në përdorim, me një optimizim maksimal të parametrave krahasur me bankat konkurrenente. U finalizuan me sukses disa fushata marketimi produktesh si Credins Online, pagesa me kartat dhe kartat pa kontakt me objektiv për të rritur përdorimin e kartave, si dhe për të reduktuar Cash-in. U lancuan fushata për kredinë verore dhe kredinë festive të cilat dhanë rezultate të kënaqshme. U ndërmorën mjaft evente për të mbështetur kredinë Agro përgjatë vitit, shoqëruar me Bankën lëvizëse, një risi për tregun bankar shqiptar. Kjo bank levizoi anëmbanë Shqipërisë duke promovuar jo vetëm brandin tonë, ofruar shërbime për klientet e zonave rurale, por duke trasmetuar imazhin e një banke digjitale dhe inovative. U finalizua me sukses një cikël emisionesh me kliente Agro të mbështetur me financim nga banka Credins, të cilët si dëshmitarët më të mirë, promovuan suportin e dhënë në rrjetet sociale dhe në Televizion. Kredia Agro tejkaloi objektivat e vendosur. Objektiv strategjik mbetet jo vetëm tërheqja e klientëve të rinj, por dhe maksimizimi i kënaqësisë së klienteve ekzistues, duke ofruar produkte atraktive dhe krijuar me ta një lidhje afatgjatë. Ndaj në bashkëpunim me Mastercard, finalizuam me sukses 7 oferta me partnerë nga më të njohurit ndërkombëtare duke ofruar discount deri në 20% nga përdorimi

Suksesi i vitit 2019 ishte edhe liçencimi i Bankës Credins nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare për ushtrimin e aktivitetit të depozitarit të sipërmarrjeve të investimeve kolektive dhe fondeve të pensionit

DEPARTAMENTI I SHITJES DHE SUPORTIT TË QIRASË FINANCIARE

Credins Leasing vazhdon të jetë zgjedhja kryesore si për bizneset ashtu edhe për individë të cilët kërkojnë financim për makineri, pajisje, mjete transporti dhe makina. Credins leasing vazhdon të mbajë pozicionim të fortë dhe rritje në treg. Përgjatë vitit 2019, rritja e parashikuar e tepricës ishte 12% kundrejt 2018 dhe realizimi i saj u arrit në 97%. U disbusuan 7.9 Milion euro duke kapur objektivat e vendosura në masën prej 107%. Një rritje mjaft të mirë pati edhe numri i disbursimeve me 111% krahasuar me një vit më parë. Portofoli i kredisë ruajti gjithashtu një cilësi të mirë duke patur një nivel të ulët të kredive me probleme. Credins leasing vazhdon të mbajë vendin e dytë në treg me 14%, e cila u shoqërua me një rritje prej 8% në 2019 kundrejt 2018 edhe pse tregu pati shtim të operatorëve të rinj. Të ardhurat nga interesat u rritën me 3% krahasuar me 2018 dhe shpenzimet për provizione u ulen me 74% krahasuar me një vit më parë. Objektivat dhe parashikimet për vitin 2020 vazhdojnë të mbeten agresive dhe realizimi i tyre do bëhet i mundur nëpërmjet një startegjie me gjithëpërfshirëse të të gjithë rrjetit të degëve përsa i takon shitjeve të reja. Do forcojmë më shumë marrëdhëniet me konçesionarët duke gjetuar skema atraktive financimi në përshtatje me nevojat e klientëve. Do punohet për të përmirësuar vazhdimisht produktet ekzistuese si përsa i takon afatit apo kohës së procesimit si dhe rritje e mëtejshme e financimit për pajisje dhe makineri sipas industrive të ndryshme. Mbajtja e kredive me probleme në nivele të pranueshme do jetë një sfidë tjetër përgjatë 2020.

e përfitueshmërisë së Bankës përmes të ardhurave më të larta nga komisionet. Gjatë vitit 2019, Departamenti i Bizneseve Alternative ka menaxhur një nga tre linjat e biznesit që do të drejtojnë prej vitit 2020, aktivitetin e ndërmjetësimit në sigurime. Shërbimi i depozitarit të sipërmarrjeve të investimeve kolektive dhe shërbimet e bankingut investues (nënshkrimi i titujve dhe shërbimet këshilluese) do të lançohen përgjatë vitit 2020. Njësia e ndërmjetësimit në sigurime gjatë vitit 2019 ka ndërmjetësuar mijëra kontrata sigurimesh për klientët kredimarrës dhe jo vetëm duke gjeneruar mbi 14.5 milionë Lekë të ardhura nga komisionet e ndërmjetësimit të policave të sigurimit. Standardizimi i procesit të sigurimit të kredimarrësve të rinj është arritja më e madhe e kësaj njësie gjatë vitit të mbyllur. Tjetër sukses i vitit 2019 ishte edhe liçencimi i Bankës Credins nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare për ushtrimin e aktivitetit të depozitarit të sipërmarrjeve të investimeve kolektive dhe fondeve të pensionit si dhe ngritja e infrastrukturës optimale për ushtrimin e këtij aktiviteti i cili, siç është theksuar edhe më sipër, do të lançohet gjatë vitit 2020. Departamenti i Bizneseve Alternative gjatë vitit 2020 do të bëjë përpjekjet maksimale për realizimin e objektiveve të tillë si: Liçencimi për shërbimin e nënshkrimit të titujve; Lançimi i shërbimit të depozitarit të sipërmarrjeve të investimeve kolektive; Liçencimi si Broker në Sigurime për klasat e Jetës, Ndërmjetësimi i një gamë të gjerë produktesh sigurimi përveç Jetës së Kredimarrësit dhe sigurimit të kolateralit; Rritja e të ardhurave nga komisionet si dhe transformimi i bankës në një “one stop shop” sa herë bëhet fjalë për shërbime e produkte financiare.

Një produkt interesant ishte dhe lancimi i “Marrëveshje me palët e treta”, ku banka nënshkroi marrëveshje me partnerë të ndryshëm për të financuar klientët e tyre, ku një pjesë e kostove të financimit merren përsipër nga partneri. Por një fokus i veçantë ka qenë gjithashtu në forcimin e mëtejshëm të marrëdhënieve me Institucionet shtetërore si dhe futja në portofol e Institucioneve të reja. Njësia bashkëpunoi ngushtë me rrjetin e degëve si dhe me Departamentin e Marketingut për të mbështetur institucionet me kërkesa specifike për përmirësimin e infrastrukturës së tyre të punës, për një shërbim sa më të mirë ndaj klientëve. U firmosën marrëveshje të reja bashkëpunimi përsa i takon procesit të punonjësve institucionale, ku këta janë mbështetur me paketën e pagës, sipas nevojave specifike të çdo punonjësi. Objektivat për 2020 janë mjaft të larta, pasi do vazhdohet me përmirësimin e mëtejshëm të produkteve ekzistuese, ku sfidë do jetë krijimi i paketave të personalizuar për target grupe të caktuara individësh ose biznese, rishikimi i kostove dhe përmirësimi i përfitueshmërisë së produkteve me objektiv për të rritur shitjet tek produktet më fitimprurëse si dhe rishikimi i kushteve standarde të bankës në linje me konkurrentet.

DEPARTAMENTI I BIZNESEVE ALTERNATIVE

Departamenti i Bizneseve Alternative, ndër njësitë organizative më të reja të Bankës Credins ka punuar për të shfrytëzuar hapësirat që ofrojnë tregjet e produkteve dhe shërbimeve jo tipike bankare me qëllim shërbimin e klientit në 360 grade si dhe rritjen


Disa prej arritjeve kryesore të produkteve të lancuara janë: kredia verore lancuar në periudhën e verës ku rezultatet ishin pozitive në lidhje me volumin dhe numrin e kredive të disbursuara (1,989 kredi të disbursuara me vlerë totale në Lek 818,831,250). Gjithashtu, kjo u pasua me kredinë festive, lancuar për festat e fundvitit, ku rezultatet ishin gjithashtu të kënaqshme pavarësisht situatës së vështirë që kaloi vendi nga termeti i 26 Nentorit 2019. Një produkt interesant që u lancua në Gusht 2019, ishte Kredia për Profesionet e lira, e cila u dizajnuar për një target grup mjaft specifik klientësh, duke u kombinuar gjithashtu me një paketë të plotë shërbimesh bankare të nevojshme për këtë grup. Kredia COSME u lancua në Shtator 2019, pas finalizimit me sukses të këtij projekti në bashkëpunim me Institucione Ndërkombëtare, duke ofruar mbulim deri në 50% për bizneset e vogla dhe të mesme, të cilat kanë një performancë të kënaqshme operationale biznesi, por nuk plotësojnë kërkesat për kollateral. Kjo kredi rezultoi mjaft e suksesshme përgjatë 3 mujorit të fundit të 2019, ku u mbështetën me financim mbi 20 biznese të vogla, të mesme, dhe Agro, me një shumë mbi EUR 1 Milion. Përgjatë Qershor- Shtator 2019, fokusi ishte gjithashtu në mbledhjen e depozitave në lek, ndaj banka doli me ofertë preferenciale, si rezultat i së cilës, targeti për depozitat në Lek u tejkalua. Përmirësimet u bënë gjithashtu tek Depozita Kaltra për ta bërë më të përshtatshme me kërkesat e rregullatorit. Gjithashtu, u lancua paketa e përfitimeve për kartëmbajtësit e kartave Mastercard Ēord duke aplikuar një skemë rimbursimi cash në nivelin 0.4% deri në 0.6% të shumës së përdoruar të kartës.

me '18. Kanalet e komunikimit ishin gjithëpërfshirëse si television, radio, gazeta, revista, pjesëmarrje në panairë, aktivitete agro dhe studentësh, intervista në media, billborde etj. Rinovuam gjithashtu të gjitha imazhet e produkteve në postera, fletpalosje, website, ATM etj. Si dhe kordinuam suksesshëm më gjithë departamentet e tjera të bankës për të arritur rezultatet më të mira nga çdo fushatë. Viti 2020 do jetë me dinamik përsa i përket sfidave që sjell. Fushata të reja produktesh do lançohen duke targetuar grupe të caktuara klientesh me paketa ose oferta specifike, promovimi i Credins Online me të gjitha funksionalitetet dhe zhvillimet e mëtejshme novative. Strategjia digjitale do jetë me fokus specifik duke rritur vëmendjen në drejtim të fushatave të vazhdueshme për aplikim online të produkteve tona në protale, web, dhe Google. Gjithashtu, finalizimi me sukses i dy projekteve mjaft interesante siç është Dega Smart dhe platforma Crowdfunding janë ne fokusin tonë duke sjellë dy risi në treg që do impaktojnë pozitivisht imazhin digjital të bankës.

DEPARTAMENTI I MENAXHIMIT TË PRODUKTEVE DHE INSTITUCIONEVE

Departamenti i menaxhimit të produkteve dhe institucioneve si njësia përgjegjëse për menaxhimin e produkteve dhe shërbimeve ekzistuese, si dhe propozimin për produkte të reja në linjë me objektivat strategjike të zhvillimit të bankës dhe ndryshimeve të tregut, mbylli një tjetër vit të suksesshëm. Përgjatë 2019, u hodhën në treg disa produkte të reja të cilat ndikuan në kapjen e objektiveve të njësisë së biznesit, duke plotësuar më mirë dhe në mënyrë gjithëpërfshirëse kërkesat e klientëve.

i kartave. Skema e besnikërisë u vazhduar më tej, duke finalizuar me sukses marrëveshje me shumë partnerë lokale dhe lançuar një fushatë të suksesshme në Dhjetor '19 me discount deri në 20% nga përdorimi i çdo karte të lëshuar nga banka Credins. Për tu vlerësuar është gjithashtu lançimi dhe promovimi i paketës studentore, ku ishim banka e parë që firmosëm marrëveshje me Bashkinë e Tiranës dhe ofruar një paketë mjaft interesante për çdo student e cila erdhi duke u pasuruar me perfitime të tjera. Gjithashtu, lançimi i paketës preferenciale të biznesit, në kuadër të ligjit të fiskalizmit, u shoqërua me hapjen e një numri të konsiderueshëm llogarish të reja (3,689 përgjatë gjysmës së dytë të '19), ose rritje me +37% krahasuar




37%

ritje e llogarive të reja

PIRAMIDA E TIRANËS

Piramida e Tiranës u ndërtua në vitin 1988 duke shërbyer si një muze në trashëgiminë e Hoxhës deri në vitin 1991. Kjo strukturë u projektua si krahë shqiponje, simbol i vetë kombit, por i dukshëm si i tillë vetëm nga lart. Ndërsa nga këndvështrimi i kalimtarit ngjason me një piramidë.



DIVIZIONI RISKUT

Fokusi kryesor i administrimit të riskut ka qenë në vlerësimin, matjen dhe diversifikimin e nevojës për kapital në bazë të klasave të aseteve të veçanta dhe ekspozimit të tyre në risk.

Divizioni i Administrimit të Riskut është përgjegjës për të identifikuar, matur, monitoruar, parandaluar dhe raportuar aktivitetin lidhur me manaxhimin e rrezikut të kredisë, të tregut, të likuiditetit dhe rrezikut operacional. Gjatë vitit 2019, strukturat e Riskut si dhe Komitetet e Riskut, Kontrollit, ALCO dhe Këshilli Drejtues kanë siguruar një menaxhim të kujdesshëm në përputhje me kuadrin rregullator përfshirë dhe atë kundër aktiviteteve për pastrimin e parave. Banka ndjek një politikë të kujdesshme në përputhje me nevojat rregullatore dhe ato strategjike në lidhje me vlerësimin dhe kontrollin e një sërë rreziqesh kryesore si risku i kredisë, i përqendrimit të kredisë, qeveritar, i kursit të këmbimit, politike e cila rishikohet periodikisht në përputhje me strategjinë e Bankës. Viti 2019 ishte me luhatje të ndjeshme të normave të interesit si për monedhën vendase ashtu dhe ato të huaja. Kjo paraqiti një sfidë për administrimin e investimeve dhe në zbutjen e ekspozimeve në risk prej tyre duke synuar ruajtjen e një niveli të përshtatshëm të rendimentit të investimeve dhe të të ardhurave nga interesat. Credins Bank, në rolin e një nga zhvilluesve të tregut për krijimin dhe mbarevajtjen e tregut dytësor të titujve të qeverisë nëpërmjet emetimeve dhe kuotimeve ditore për çmimet e titujve referencë, ka kontribuar ndjeshëm në rritjen e transaksioneve dhe efikasitetin e këtij projekti madhor. Në diversifikimin e investimeve jemi fokusuar në gjetjen

dhe monitorimin e investimeve me ekspozim të ulët në risk, shoqëruar me forma të mbrojtjes ndaj riskut nëpërmjet derivateve, si një risi në tregun vendas. Vemendja ka qënë dhe në diversifikimin e ekspozimeve ndaj kundërpartive kryesore të investimeve në tituj të borxhit, veçanërisht sipas shteteve që përbëjnë totalin e portofolit të investimeve, shoqëruar edhe në diversifikimin e këtij portofoli për treguesit e riskut sipas kohëzgjatjes financiare dhe rikthimit të pritshëm. Janë respektuar objektivat dhe kufijtë për risqet e tregut, veçanërisht për riskun e likuiditetit, duke përmbluar nevojat e Bankës për likuiditet në çdo monedhë. Pavarësisht sfidave të tregut ndërbankar dhe atij të titujve, në bashkëpunim me Departamentin e Thesarit, kemi ruajtur një qasje të kujdesshme për administrimin e likuiditeteve duke ruajtur një performancë të mirë për sa i takon normave të interesit të cilat kanë qenë në rënie të vazhdueshme.

Banka në përputhje me standardet ndërkombëtare ka aplikuar rishikimet më të fundit të 'Basel 3' në lidhje me matjen dhe monitorimin e riskut të likuiditetit dhe të normës së interesit, veçanërisht me zbatimin e vlerësimeve të riskut për raportin e mbulimit të likuiditetit dhe sipas rregulloreve të autoritetit mbikëqyrës. Janë ndërmarrë masa për implementimin e sistemit në lidhje me automatizimin e procesit për përlogaritjen e indikatorit sipas kërkesave rregullatore.

Fokusi kryesor i administrimit të riskut ka qenë në vlerësimin, matjen dhe diversifikimin e nevojës për kapital në bazë të klasave të aseteve të veçanta dhe ekspozimit të tyre në risk. Banka ka kryer një vlerësim të nevojës së brendshme për kapital duke përfshirë një sërë risqesh të veçanta, që janë jashtë kuadrin rregullator për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit, si risku i përqendrimit të kreditimit, riskut të vendit, riskut të mbetur të tregut, riskut të pronave në pronësi, riskut reputacional dhe strategjik, shoqëruar me skenare stresit për secilin prej risqeve kryesore. Inventarizimi i risqeve që Banka mund të ekspozohet na mundëson një vlerësim më të gjerë të ekspozimit në risk, jo vetëm të aseteve në dispozicion, por të gjithë aktivitetit dhe operacioneve duke vlerësuar nevojën për kapital shtesë.

Fokus të rëndësishëm ka pasur në mirëadministrimin e vlerësimeve të kolateraleve për mbulimin sa me lartë të ekspozimeve në risk dhe përfshirjen e një game më të gjerë të llojeve të kolateraleve, përfshirë edhe instrumentave të reja financiare dhe produkteve të sigurimeve. Përtej përmirësimeve të cilësisë së kolateraleve të marra si garanci për ekspozimet në risk, banka është angazhuar në përmirësimet e raporteve të mbulimit të ekspozimeve nëpërmjet instrumentave për mbrojtjen e financiar të kredisë.

Nga Janari 2018, Banka ka aplikuar standardin e ri IFRS9 për modelin e biznesit, vlerësimin dhe klasifikimin e aseteve me risk nëpërmjet disa shkallëve, llogaritjen e humbjeve të kreditimit sipas jetëgjatësisë së ekspozimeve të klasifikuara për shkallën e dytë në risk. Janë kryer përmirësime si në metodologjitë dhe në automatizimin e këtij procesi për llogaritje vlerës së provigjionimeve. Banka është fokusuar në përmirësimin dhe rritjen e efikasitetit të investimeve në përputhje me objektivat për volumet e fondit dhe shpenzimit për provigjionime përgjatë vitit dhe për buxhetimin afatmesëm. Gjate vitit 2019, u përmirësua procedura për identifikim të databazës së rrezikut operacional duke u kordinuar me të gjitha njësitë e bankës.

Kredidhënia përgjatë 2019 është bazuar në njohjen më të mirë të klientëve dhe në veçoritë e sektoreve ku operojnë. Fokusi ka qënë segmenti i bizneseve të vogla dhe të mesme si dhe agrobiznesi të cilët patën rritje në numër dhe volum të kredive të disbursuara, mbështetur dhe me skema lehtësuese kollaterali nga bashkëpunimi me Institucione ndërkombëtare.

Nga Qershor 2019, Banka është angazhuar në implementimin dhe garantimin e përputhshmërisë me kërkesat e rregullores së Bankës së Shqipërisë "Për shtesat makroprudenciale të kapitalit".

Credins Bank ka synuar të ketë një balancim mes përthithjes së fondeve në monedha të ndryshme dhe investimit të tyre nëpërmjet dhënies së huave në këto monedha. Në kredidhënie kemi ndjekur politikën e zbutjes së ekspozimit ndaj riskut indirekt të kredisë si pasojë e kursit të këmbimit, duke rekomanduar marrjen e huave nga klientët në monedhë të njëjtë me të ardhurat e tyre ose konvertimin e huave ekzistuese në Euro drejt monedhës vendase duke ndërgjegjësuar klientët për risqet e mundshme nga luhatjet e kurseve të këmbimit. Kjo gjë shfaqet në një nivel më të ulët të Credins Bank ndaj këtij ekspozimi në raport me të dhënat e publikuara si për kreditë dhe për depozitat që ka sistemi bankar vendas.

MUZEU HISTORIK




Muzeu Historik u përrua më 28 tetor 1981 dhe është institucioni muzeor më i madh në Shqipëri. Zë një sipërfaqe të përgjithshme prej 27.000 m² dhe ka një sipërfaqe ekspozimi prej 18.000 m².

Mozaiku i fasadës së Muzeut Historik Kombëtar është një mozaik gjigand me dimensione 10 x 40 m, i cili zotëron sheshin "Skënderbe". Sipërfaqja është 400 m².



DIVIZIONI OPERACIONAL

Divizioni Zhvillimit të Biznesit mbështetet nga Departamenti IT-së me tendencat e fundit të teknologjisë për zhvillimin e ofrimin të produkteve të reja inovative.



DEPARTAMENTI OPERACIONAL

Departamenti Operacional, si struktura qendrore në mbështetje të procesimit korrekt dhe në kohë të të gjithë pagesave brenda dhe jashtë Shqipërisë, vazhdoi edhe përgjatë 2019 të përmbushë me profesionalizëm rolin e tij duke kontribuar në rritjen e vazhdueshme të cilësisë së procesimit. Profesionalizmi dhe saktësia në procesim dhe rritja e këtyre transaksioneve kanë qënë evidente dhe faktor në qëndrueshmërinë dhe mbarëvajtjen e marrëdhënieve

të bashkëpunimit me Bankat jorezidente, duke sjellë rritje të bashkëpunimit reciprok me këto Banka. Departamenti ka qënë pjesëmarrës shumë aktiv e produktiv me ekspertizën e tij në produkte apo shërbime të ndryshme, përmirësime të proceseve dhe procedurave të punës apo të marrëveshjeve të lidhura me palë të treta. Vijoi perfeksionimi i procesimit të transfertave në mbërritje duke përmirësuar shpejtësinë e procesimit. Kjo do ndihmojë në zhvillimet që do kryehen nën dritën e nismës së

SWIFT-it, për zbatimin e Konfirmimit të Kreditimit Universal i cili do fillojë të zbatohet në fund të 2020. Nëpërmjet kësaj nisme, çdo Bankë është e detyruar të konfirmojë kreditimin e transfertës në favor të përfituesit: vlerën e kredituar, komisionet e ndalura dhe kohën e procesimit duke rritur transparencën me klientet.

Automatizimi i proceseve, mundësimi i risive në instrumentat e pagesave dhe aplikimi i konfirmimit të kreditimit universal do jenë objektivat përgjatë vitit 2020.

Credins Bank përgjatë 2019, ka procesuar në kohë reale nëpërmjet sistemeve AIPS dhe AECH dhe Bankave Korrespondente, një fluks të konsiderueshëm transfertash. Numri I transfertave të procesuara në mbërritje, në monedhën vendase dhe valute, u rrit 27% krahasuar me 2018 dhe ato në nisje u rritën 22% krahasuar me 2018. Rritje të konsiderueshme patën dhe pagesat nëpërmjet kanaleve digjitale si pagesa e detyrimeve Utilitare, Tatim-Taksat, Doganat, transfertat bankare brenda dhe jashtë vendit, të cilat shënuan një rritje prej më shumë se 200% në numër krahasuar me 2018.

Instrumentat e Financave Tregtare si Letër-kreditë, Garancitë me jashtë dhe 'incaso'-t vijuan të jenë pjesë e pagesave dhe angazhimeve bankare duke iu ofruar klientëve një shërbim profesional dhe korrekt. Eshte shënuar një rritje e numrit të tyre prej rreth 50% krahasuar me 2018. Vihet re një përdorim më i gjerë i Incaso-ve dhe L/C-ve të Eksportit, krahasuar me vitin e kaluar.

Pagesat Utilitare, Tatim-Taksa, Dogana po ashtu kanë shënuar një rritje prej 53% në numër transaksionesh krahasuar me vitin 2018. Credins Bank është një nga bankat kryesore në vend për shërbimin e procesimit të pagave dhe pensioneve për kompanitë dhe institucionet shtetërore, me një trend në rritje përgjatë 2019. Si rrjedhojë e volumeve të kryera për të gjitha shërbimet e pagesave, të ardhurat nga komisionet kanë shënuar rritje krahasuar me vitin 2018.

DEPARTAMENTI IT-SE

Nisur nga roli i Departamentit të IT-së në Bankë, strategjia e Bankës, tendencat e tregut dhe ato teknologjike, IT-ja ka suportuar apo udhëhequr njësitë e biznesit në zhvillimin e ofrimin të produkteve të reja inovative. Për të munduruar këto, gjatë 2019 u bënë ndryshime thelbësore në infrastrukturën ekzistuese të serverave, të cilat sollën një cilësi më të mirë komunikimi dhe shërbimi për degët e bankës. Departamenti i IT-së ka mbështetur zhvillimin e projekteve të bankës, ku më i rëndësishmi ishte zhvillimi i mëtejshëm i platformës Credins Online për ta bërë më të thjeshtë aksesimin dhe përdorimn e tij, nga çdo klient i bankës. Kjo u shoqërua dhe me ngritjen e një strukture specifike e cila punoi për të rritur funksionalitetet e aplikacionit si pagesa vetëm me një numër telefoni, dërgimi i notifikimeve të ndryshme tek klientët për oferta dhe shërbime si dhe për ta bërë më "user friendly" për klientët. Kjo u shoqërua dhe me një suport të vazhdueshëm online nëpërmjet kanaleve të reja të komunikimit si email dhe whatsapp për çdo problematikë të hasur nga ana e klientëve, si dhe me përgatitjen e videove tutoriale informuese. Gjithashtu përgjatë 2019, është punuar për përmirësimin e vazhdueshëm të raporteve për njësitë e biznesit dhe drejtuesit e bankës, duke i automatizuar dhe thjeshtuar për një përdorim gjithëpërfshirës dhe në kohë reale. U automatizua procesi i printimit të kontratave nëpër degë dhe procesi i aprovimeve të paradhënies bankare duke suportuar stafet e degëve për një rritje të efektivitetit në punë.

Gjithashtu, u përmirësuan procese të tjera punë të lidhura me transfertat, kushtet e punës të bankës, procese të tjera operacionale lidhur me trasaksione të caktuara në bankë, drejt një automatizimi të mëtejshëm duke reduktuar punën manuale dhe përmirësuar efektivitetin e proceseve nëpërmjet reduktimit të mëtejshëm të riskut.

Përgjatë 2019 u lancua dhe shërbimi i bankës levizëse si një risi inovative ku shërbimet bankare përfshirë dhe shërbimet e ATM u mundësuan për çdo klient të zonave rurale sikur të ishte një degë banke duke siguruar funksionalitet të plotë të sistemeve. Përmirësimi i strukturës Help desk ishte gjithashtu në fokus (janë trajtuar më shumë se 28,000 kërkesa) si dhe suportu i vazhdueshëm i të gjitha degëve përsa i takon sistemeve dhe funksionalitetit të tyre, duke përfshirë dhe degët që u rialokuan. Janë mbështetur stafet e degëve me mbi 100 trajnime të ndryshme. Përgjatë 2020, synimi ynë kryesor do vazhdojë të mbetet zhvillimi i vazhdueshëm i platformës Credins Online, me objektivat për hapjen e llogarisë bankare dhe depozitës pa afat online nga aplikacioni për klientët ekzistues si dhe integrimi i kësaj platforme me Bursen dhe Credins Invest. Ndjekja e mëtejshme e projekteve të bankës në koordinim dhe me njësinë e projekteve dhe njësitë e tjera të involvuara si: përmirësime të mëtejshme në proceset e transfertave, ndjekja e projektit për arkivën digjitale të bankës, ndërtimi i një sistemi komunikimi me anë të sms-së për klientët për trasaksione të caktuara në llogaritë e tyre, hapja e BankUp duke paraprirë psd2, përmirësimi i mëtejshëm i



sistemeve të raportimit, ndërtimi i intranetit të bankës, etj. Gjithashtu, fokus do jetë dhe përmirësimi i vazhdueshëm i infrastrukturës dhe i teknologjisë në linje me standardet dhe zhvillimet e mëtejshme të tregut, si dhe përmirësimi i proceseve dhe procedurave të brendshme të departamentit.



DEPARTAMENTI THESARIT

Departamenti i Thesarit rregjistroi një ecuri mjaft positive në 2019, edhe pse tregjet financiare vazhdojnë të operojnë me norma shumë të ulta interesi. Objektivat kryesore kanë qenë manaxhimi i likuiditetit, suporti i veprimtarive kyçe të bankës dhe rritja e të ardhurave nga veprimtaritë kryesore dhe nga investimet në Tituj dhe këmbimet valutore. Viti 2019 ishte një vit i suksesshem, pasi rezultoi me rritje positive në disa tregues. Të ardhurat nga veprimtaria e Sektorit të Tregut të Parasë dhe Titujve u rriten me 18% krahasuar me 2018. Portofoli i depozitave të bankës u rrit ndjeshëm duke ruajtur normat e interesit në nivelin e sipërm për tregun vendas. Të ardhurat nga këmbimet valutore u rriten me 11% në krahasim me 2018. Forcimi i mëtejshëm i marrëdhënieve me bankat jorezidente çoi në ulje të kostove dhe rritjen e volumeve të tregtimit midis palëve. Përgjatë 2019, Credins Bank si një nga pesë bankat e përzgjedhura si Zhvillues të Tregut për obligacionet referencë, pati në fokus rritjen e tregtimit të letrave në tregun sekondar, shoqëruar me trajnime të vazhdueshme për stafin shitës të degëve, për t'u mundësuar klientëve një informacion sa më të plotë për funksionimin dhe rregullat e reja të ankandëve të obligacioneve referencë. Kemi mundësuar dhe informim online në eëbsite-in e bankës për çdo klient për kuotimet e obligacioneve referencë duke identifikuar momentin më të përshtatshëm të investimit. Gjatë 2019, Banka zgjerojë gamën e produkteve duke ofruar tregtimin e Eurobondit Shqiptar në tregun sekondar vendas. Gjithashtu, si anëtare e Bursës Shqiptare të Titujve, ofruam tregtimin e letrave

me vlerë në të gjithë rrjetin e degëve për klientët. U shënuar një rritje e ndjeshme e volumit të tregtimit jo vetëm në monedhat kryesore por dhe dytësore, si monedha Britanike GBP (kyesisht prej çështjes BREXIT) dhe AUD, JPY dhe CAD. Transaksionet në AR u dyfishuan në krahasim me 2018, duke vazhduar të jemi e vetmja bankë që ofron investime në AR, i cili mbetet një "strehë" e sigurt në periudhat me luhatshmëri të lart dhe pasiguri të tregjeve financiare. Emetimet e reja të obligacioneve të Bankes Credins në 2019, rezultuan të suksesshme ku kërkesa tejkaloi ofertën. Klientët e shikojnë këtë produkt një alternativë shumë të mirë investimi. Banka Credins, për të 9-in vit rradhazi, vazhdon të jetë pararojë në rolin e kujdestarit të obligacioneve të emetuara nga shoqëritë aksionare, duke ofruar jo vetëm kushte konkurruese por edhe ekspertizë në këtë fushë. Banka Credins u licensua nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare për ushtrimin e brokerimit të titujve duke zgjeruar të gjithë gamën e veprimeve me Tituj në bursë dhe në tregun sekondar. Menaxhimi efektiv i likuiditetit, ulja e kostove, tregtimi 24-orë i monedhave, kanalizimi i ofrimit të produkteve të thesarit nëpërmjet Credins Online, promovimi dhe rritja e transaksioneve në tregun sekondar të letrave me vlerë janë objektivat kryesore të 2020. Ndjekja e ecurisë së tregjeve financiare nga një staf i kualifikuar dhe ofrimi i mundësive më të mira për klientët në lidhje me investimet, mbeten një sfidë e vazhdueshme.


DEPARTAMENTI KARTAVE

Diversifikimi i portofolit të produkteve dhe shërbimeve që lidhen me kartat mbeten prioriteti kryesor në fushën e pagesave elektronike dhe një sfidë e përhershme e bankës. Synimi ynë është që çdo individ dhe biznes të përfitojë produktin që i përshtatet më tepër nevojave dhe kërkesave të tij.

Përgjatë 2019, është konsoliduar pozita e bankës në tregun bankar për të gjithë treguesit sasiore dhe cilësore që lidhen me kartat. Kartat e parapaguara Visa (Lek) dhe Mastercard (Euro) vazhdojnë të kërkojnë individë të të gjitha moshave. Kartat e parapaguara ishin një sukses në vitin 2011 kur u lançuan dhe në vite kanë tejkaluar pritshmëritë përse I takon kënaqësisë në përdorim dhe rritjes së numrit dhe volumit të trasaksioneve. Volumi I transaksioneve për kartat e parapaguara u rrit me 50% (Visa & MC) në 2019 krahasuar me 2018. Gjithshtu rritje pati dhe lëshimi I kartave MC World, të cilat ofrohen në tregun bankar shqiptar vetëm nga Credins, duke i siguruar klientit përdorues përfitime shtesë, specifike vetëm për këtë tip karte. E gjithë gama e produkteve të kartave Visa dhe MC të lëshuara në çdo monedhë dhe për çdo target grup klientësh janë të teknologjisë chip contactless, duke I bërë transaksionet më të thjeshta dhe të sigurta. Banka ka vazhduar të mbështesë institucionet publike nëpërmjet kartave të biznesit Visa dhe MC të konceptuara specifikisht për këtë kategori. Janë përmirësuar treguesit e pranimit të kartave në терминаlet Credins duke shënuar rritje në volum (41% per kartat Visa dhe 118% per kartat MC). Është ritur numri I bizneseve që kanë kërkuar

shërbimin E-Commerce nëpërmjet të cilit klientëve ju ofrohet mundësia e pranimit të pagesave me kartë online në терминаlet virtuale. Credins ka qënë ndër bankat e para që e ka ofruar këtë shërbim dhe mbetet një nga aktorët kryesor në tregun bankar shqiptar që nxit biznesin për ofrimin e këtij shërbimi. Pranimi në терминаlet virtuale E-Commerce është rritur në masën 55% në vitin 2019 krahasuar me 2018.

Objektvat për 2020 janë të shumta, pasi synojmë një rritje të mëtejshme të përdorimit të kartave në vend dhe edukim të mëtejshëm të qytetarëve të cilat ndikojnë dhe në reduktimin e pagesave cash në ekonomi duke reduktuar informalitetin. Gjithashtu, fokusi do jetë në zgjerimin e potofolit me produkte të reja si: karta e parapaguar Mastercard në USD apo panimi i pagesave në EURO në терминаlet fizike dhe virtuale Credins. Synojmë të finalizojmë projektin për përmirësimin e teknologjisë që lidhet me sigurinë e blerjeve online, duke e kaluar këtë proces në një fazë të re autentifikimi dhe duke I bërë transaksionet online edhe më të sigurta. Do përfundojë projekti për personalizimin e kartave me një kompani shqiptare, duke sjellë shkurtimin e kohës së prodhimit dhe dorëzimit të kartës tek klienti. Në fokus të synimeve dhe përpjekjeve tona të vazhdueshme ka qënë dhe mbetet klienti, ndaj skema e besnikërisë duke kombinuar lëshimin e kartave me përfitime shtesë do jetë gjithmonë prioriteti ynë për një klient më besnik dhe të kënaqur.



55%
është rritur pranimi në programet virtuale E-Commerce

ISH – KINOSTUDIO “SHQIPËRIA E RE”

Ky kompleks neoklasik u projektua në vitet 1950-1952.

Dikur ka qenë ndërtesa e Studios Kombëtare Shqiptare të Filmit e njohur si Kinostudio “Shqipëria e Re” si dhe e Arkivave Kombëtare të Filmit. Sot këtu ndodhen Qendra Kombëtare Shqiptare e Kinematografisë, Akademia e Filmit dhe Multimedias “Marubi”, Ministria e Kulturës, Instituti i Monumenteve të Kulturës, etj. Filmi i parë artistik i prodhuar nga Kinostudio është “Skënderbeu” në vitin 1953. Kinostudio “Shqipëria e Re” ka prodhuar dhe shpërndarë shumë filma shqiptarë rreth 13-14 filma në vit.



**KËSHILLI
DREJTUES**

CREDINS bank



SAJMIR SALLAKU
KRYETAR

JONAS HASSELROT
ANËTAR

CLIVE MOODY
ZV. KRYETAR

RAIMONDA DUKA
ANËTARE


MONIKA MILO
ANËTARE

ELTON TORO
ANËTAR

MALTIN KORKUTI
ANËTAR

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS

Ndërtesa e Universitetit Politeknik të Tiranës u ndërtua në vitin 1942, projektuar nga arkitekti italian Gherardo Bosio. Arkitektura e saj karakterizohet nga paralelopipedë kompaktë të bashkuar me njëri-tjetrin që të jep përshtypjen e një kalaje romake dhe sjell në kujtesë kullën tradicionale shqiptare e performuar në kushtet e modernizmit.



DEPARTAMENTI PROJEKTEVE

Fondi European i Investimeve dhe Banka Credins nënshkruan një marrëveshje në shumën prej 75 milion euro për financim të ndërmarrjeve të vogla dhe mesme shqiptare, si pjesë e programit për garantimit e huave Cosme të ofruar nga Bashkimi European.



Gjatë vitit 2019, departamenti I projekteve finalizoi me sukses disa projekte mjaft të rëndësishme, të cilat ndikuan në përmirësimin e mëtëjshëm të aktivitetit të bankës.

Projekti i ri COSME u lançua në Gusht 2019. Fondi European i Investimeve dhe Banka Credins nënshkruan një marrëveshje në shumën prej 7.5 milion euro për financim të ndërmarrjeve të vogla dhe mesme shqiptare, si pjesë e programit për garantimit e huave Cosme të ofruar nga Bashkimi European. Fondi European i investimeve ka si mision kryesor mbështetjen e bizneseve evropiane shumë të vogla dhe të



mesme, duke i ndihmuar të kenë akses në financim me hua një numri të konsiderueshem biznesesh të cilat gezojnë qëndrueshmëri financiare, kanë një plan të mirë biznesi por nuk plotësojnë kërkesat e bankës për mbulim me garanci. Ky projekt ka qënë mjaft i suksesshëm përgjatë 2019 ku shumë kliente biznesi janë mbështetur me financime duke plotësuar nevojat e tyre për zhvillim dhe rritje.



Depozitari është një projekt tjetër i finalizuar me sukses ku Credins Bank u liçensua nga ana e Autoritetit të Mbiqyrjes Financiare për ushtrimin e veprimtarisë së depozitarit të fondeve të pensioneve dhe fondeve të investimeve. Është kërkesë ligjore që çdo fond i pensioneve vullnetare dhe fondi i sipërmarrjes së investimeve kolektive të këtë një kontratë bashkëpunimi me një bankë të liçensuar si depozitar e cila do sigurojë asetet e krijuara nga këto fonde. Ky shërbim i ri është në përputhje me objektivat e Bankës Credins për të ndërtuar një

model biznesi të diversifikuar dhe të qëndrueshëm si edhe përpjekjeve të saj për të qënë sa me pranë ndryshimeve të tregut. Liçencimi për këto shërbime shënon zgjerimin e mëtëjshëm të aktivitetit të Credins në tregun financiar jobankar.

Një tjetër aktivitet i rëndësishëm gjatë 2019 ishte projekti i ri-inxhinjerimit të proçeseve të ndara sipas kategorive kryesore: proçese që realizohen në degë, në drejtorinë qëndrore dhe proçese që lidhen me bankingun online. Është përfunduar faza e parë e projektit duke identifikuar të gjitha proçeset që realizohen në degë dhe është përfunduar mapimi i pothuajse 80% të këtyre proçeseve. Projekti do vazhdojë përgjatë 2020 dhe të jetë një kontribues i mëtëjshëm i automatizimit të proçeseve të punës në bankë duke rritur ndjeshëm eficiency.


Depozitari është një projekt tjetër i finalizuar me sukses ku Credins Bank u liçensua nga ana e Autoritetit të Mbiqyrjes Financiare për ushtrimin e veprimtarisë së depozitarit të fondeve të pensioneve dhe fondeve të investimeve.

Gjithashtu, kemi vazhduar modernizimin teknologjik në mbështetje të objektivit strategjik për të gjeneruar më shumë biznes nëpërmjet kanaleve online, duke e shoqëruar me investime të konsiderueshme në sisteme dhe infrastrukturë.

Objektiva të rëndësishëm për 2020 mbeten implementimi i sistemit CRM i cili synon një sistem të dizenuar për të organizuar, automatizuar, sinkronizuar proçeset e biznesit dhe aktivitetet e shitjes dhe marketingut, shërbimin ndaj klientit dhe suportin teknik si dhe krijimi i arkives elektronike.

URA E TABAKËVE

Ura e Tabakëve është një urë guri këmbësoresh e periudhës otomane të shekullit XVIII e ngritur me kontributin e Esnafit të Tabakëve për të kaluar mbi Lanë. Ajo ka një lartësi rreth 7 metër e gjysmë dhe përbëhet nga një hark kryesor, mbi të cilin ngrihet ura në formë kurrizi. Lartësia nga niveli i ujit ka qenë 3,5 metra.



DEPARTAMENTI BURIMEVE NJERËZORE

Në fokus gjatë 2019 ka qenë rritja e kënaqësisë në punë të punonjësve nëpërmjet vlerësimit dhe zhvillimit të vazhdueshëm të tyre dhe përdorimit të një sistemi insentivash.

STRATEGJIA E DEPARTAMENTIT TË BURIMEVE NJERËZORE.

Objektiv kryesor i punës së Departamentit të Burimeve Njerëzore janë punonjësit tanë. Në fokus gjatë 2019 ka qenë rritja e kënaqësisë në punë e çdo pjesëtari të familjes së madhe Credins, nëpërmjet vlerësimit dhe zhvillimit të vazhdueshëm të tyre dhe përdorimit të një sistemi të drejtë e konkures insentivash. Kemi besuar në skuadrën tonë dhe kompaninë e ndërtuar deri tani, duke rritur investimet për rekrutimin, trajnimin dhe zhvillimin e asetit më të rëndësishëm të bankës, kapitalit njerëzor.

DIVERSITETI I STAFIT.

Viti 2019 u mbyll me 921 punonjës ose 5.4 përqind më tepër së një vit më parë. Mosha mesatare e stafit është 35.8 vjeç dhe ndarja sipas gjeneratave të ndryshme është:

- ◇ Gjenerata Y, moshë 22-35 vjeç. 55 përqind
- ◇ Gjenerata X, moshë 36-50 vjeç. 33 përqind
- ◇ Baby Boomers', moshë mbi 51 vjeç 12 përqind

Raporti meshkuj/ femra në fundin e vitit 2019 ishte 74.7% me 25.3% në favor të femrave.

Numri i punonjësve në nivel menaxherial ishte 277, ku 81.2% janë drejtuese femra dhe vetëm 18.8% meshkuj. 42% e stafit ose 387 punonjës janë në Drejtorinë Qendrore dhe 58% ose 534 në rrjetin e degëve.

Gjatë 2019 kujdes i veçantë i është kushtuar rekrutimeve cilësore. Janë zhvilluar 485 intervista pune, janë kryer 120 testime paraprake dhe 299 pas testime. Në total janë rekrutuar 132 punonjës, ku rreth 80% janë punësuar në degë. Trainimi i stafit ka pasur rritje cilësore dhe sasore falë edhe rritjes së buxheteve të alokuara për zhvillimin e punonjësve. Janë zhvilluar në total 49,426 orë trajnime nga të cilat:

- ◇ 12,696 orë trajnime për stafin ekzistues
- ◇ 21,280 orë trajnime për punonjësit e rinj
- ◇ 12,000 orë trajnime për stafin që ka levizuar në pozicione të reja ose promovuar.
- ◇ 3,450 orë trajnime teorike të zhvilluara gjatë programit të parë #youarecredins.

Në mënyrë të përmblodhur kemi këtë paraqitje grafike të trajnimeve:

RISI PROGRAMI “#YOUARECREDINS”.

Gjatë 2019 është lancuar programi i rekrutimit dhe trajnimeve të studentëve të ekselencës të diplomuar në shkencat ekonomike, informatike apo juridike. Seleksionimi i tyre është kryer nëpërmjet testimeve online dhe vlerësimeve në grup. Për të dyja programet kanë aplikuar 687 kandidatë, janë testuar me shkrim 427 prej tyre dhe kanë kaluar në grupe vlerësimi 207 kandidatë.

Praktikantët që rekrutohen nga ky program trajnohen në teori dhe praktikë nga ekspertët më të mirë të bankës dhe nga trajnues të jashtëm me qëllim zhvillimin e aftësive teknike, veçanërisht të shitjes dhe njohjes me rregullorët e procedurat e punës në bankë.

Objektivat kyesore për 2020 do vazhdojnë të jenë investimi i vazhdueshëm tek stafet për zhvillim të vazhdueshëm profesional dhe për një shërbim sa më të mirë ndaj klienteve si dhe vazhdimi i programit “youarecredins” për të rekrutuar talente të reja për t’ju bashkuar familjes Credins.



**DITË
TRAJNIMI**

Orët totale të trajnimit /
8 orë në ditë



**DITËT MESATARE
PËR NJË PUNONJËS**

Ditët e trajnimit/ nr. mesatar të
punonjësve (852)



**PUNONJËS
TË TRAJNUAR**

se paku me një trajnim,
nderkohë që në total kanë marrë
pjesë 2,934 punonjës



**ORË TOTALE
TRAJNIMI**




**KANDIDATË TË
PERZGJEDHUR**

për të dy programet
#youarecredins

BANKA E SHQIPËRISË

Ndërtesa e Bankës së Shqipërisë u projektua nga prof. Vittorio Ballio Morpurgo. Ceremonia e përrimit të saj u zhvillua në 30 tetor 1938. Stili arkitekturor i bankës i përket rrymës së Racionalizmit, rrymë e cila lulëzoi në gjysmën e parë të shekullit XX në Evropë. Ky stil shquhet për volumet e mëdha dhe linjat e forta në fasada.



PËRGJEGJËSIA SOCIALE

Përgjatë 2019, kemi mbështetur mbi 70 iniciativa në linjë dhe me 17 Objektivat për një zhvillim të qendrueshëm të OKB.



Aktivitetet e ndërmarra dhe mbështetura nga Credins Bank, në kuadër të Përgjegjësisë Sociale në përputhje me 17 Objektivat për Zhvillim të Qendrueshëm.

Përgjegjësia sociale është në një fokus të veçantë të Credins Bank, drejtuesve dhe aksionerëve të saj, pasi besojmë fort që rritja dhe zhvillimi i vazhdueshëm bankës është i lidhur me një zhvillim të përgjithshëm të ekonomisë së vendit dhe të mirëqënies sa më të mirë të të gjithë qytetarëve.

Përgjatë 2019, kemi mbështetur mbi 70 iniciativa në linjë dhe me 17 Objektivat për një zhvillim të qendrueshëm të OKB. Kemi bashkëpunuar me organizata dhe projekte të ndryshme që ndihmojnë në eliminimin e varfërisë për shtresat në nevojë dhe për fëmijet pa përkujdesje prindërore. Credins Bank është një institucion gjithmonë në mbështetje të promovimit të një jetese të mirë dhe ka një rol kyç në sensibilizimin e popullsisë për një mirëqenie dhe jetesë të shëndetshme. Kemi bashkëpunuar me organizata humanitare si Kryqi i Kuq Shqiptar apo fshati SOS duke

dhuruar ushqime, gjak, apo produkte të tjera jetike për shtresat e varfra apo fëmijët jetime, talasemikë si dhe kemi dhuruar libra për një shkollim më të mirë. Kemi mbështetur të moshuarit me ushqime apo matariale të tjera jetike si dhe kemi kontribuar për një sensibilizim për fëmijët autike në mbarë shoqërinë duke i mbështetur sadopak financiarisht projektet e tyre.

Kemi mbështetur zhvillimin e bujqësisë duke bashkëpunuar me institucione të rëndësishme si Fondi European i Investimeve për t'u dhënë më shumë akses bizneseve Agro në

sistemin bankar, duke krijuar lehtësira në financim. Kemi levizuar me Bankën levizëse në shumë zona rurale duke informuar dhe edukuar klientët Agro për shërbimet tona, apo kemi marrë pjesë në mjaft panairë Agro pasi një bujqësi më e shëndetshme do të thotë më shumë ushqime dhe më pak varfëri.

Një fokus i veçantë ka qenë dhe bashkëpunimi me shumë institucione shtetërore të shëndetësisë në të gjithë Shqipërinë, duke dhuruar pajisje të ndryshme për spitale, maternitete apo qendra shëndetësore, të cilat ju vijne në ndihmë qytetarëve për një shërbim më cilësor.

Duke e vlerësuar arsimin, kulturën dhe artin si një kontribut mjaft të çmuar në dobi të komunitetit për një zhvillim të vazhdueshëm, si dhe përfshirjen e të rinjve në punësim kemi mbështetur mjaft aktivitete artistike në vend, si dhe kontribuar në pajisjen e shkollave me pajisje kompjuterike apo mjete të tjera të

nevojshme duke bashkëpunuar me mjaft shkolla dhe Drejtori Arsimore në mbarë vendin.

Përmendim gjithashtu mbështetjen e vazhdueshme për bizneset start up në Shqipëri dhe rajon, si dhe idetë inovative të prezantuara në konkurse të ndryshme duke kontribuar në zhvillim të mëtejshëm të ekonomisë dhe teknologjisë si dhe pjesëmarrjen në panairët e punës për një punësim më të mirë të të rinjve.


Credins Bank është një aktor i rëndësishëm në ndërtimin e një komuniteti aktiv dhe qyteteve me zhvillim të qëndrueshëm, duke investuar në aktivitete kulturore dhe promovuese të artit në të gjithë vendin. Nëpërmjet financimit të këtyre iniciativave, banka synon të forcojë dhe nxisi përpjekjet për të mbrojtur dhe garantuar trashëgiminë kulturore dhe natyrore të botës. Kemi mbështetur mjaft aktivitete sportive, si maratona, alpinizëm, basketboll, taekwondo, volejball etj. Si dhe mjaft

koncerte të këngëtarëve më të njohur të muzikës popullore shqiptare në të gjitha qytetet e Shqipërisë. Së fundmi, një kontribut i veçantë jepet dhe në fushën e mjedisit për një klimë më të shëndetëshme dhe mjedis më të pastër. Kemi kontribuar në krijimin e parqeve të gjelbërt dhe argëtues për fëmijët e komunitetit, apo mbjellje pemësh për një ajër më të pastër.

Credins bank do vazhdojë të kontribojë më shumë për të gjitha shtyllat kryesore që ndikojnë në zhvillim dhe mirëqenie të përgjithshme të vendit dhe qytetarëve dhe do jemi partnerët tuaj më të ngushtë pasi vetëm së bashku mund të krijojmë një të ardhme më të mirë për vete, fëmijet dhe pasardhësit tanë.

MONUMENTI “NËNA SHQIPËRI”

Ky monument prej betoni është 12 metra i lartë dhe është përruar në vitin 1971, përfaqëson Shqipërinë si një nënë që ruan gjumin e përjetshëm të atyre që dhanë jetën për të. Monumenti masiv mban një kurorë me dafina dhe një yll të ngritur lart me dorën e djathtë. Ai qëndron mbi një pedestal prej 3 metrash të lartë, ku janë gdhendur fjalët “Lavdi e përjetshme dëshmorëve të Atdheut”.



QEVERISJA KORPORATIVE

DREJTIMI I BRENDSHËM

Banka angazhohet për të pasur një qeverisje sa më të mirë duke zhvilluar më tej:

- Menaxhimin e përgjegjshëm, i përshtatshëm dhe i bazuar në vlera;
- Mbikëqyrjen efektive dhe organe ekzekutive që veprojnë në interesin më të mirë të bankës dhe aksionarëve të saj, përfshirë aksionarët me pakicë aksionesh, si dhe rritjen e vlerës së investimit të aksionarëve në mënyrë të qëndrueshme; dhe
- Publikimi dhe transparenca e duhur e informacionit, si dhe një sistem efektiv i administrimit të rrezikut dhe kontrollit të brendshëm.

Themeli i besimit midis aksionarëve, drejtorëve dhe menaxherëve përbëhet nga katër shtylla të qeverisjes së korporatave:

- Transparenca: Banka siguron që informacionet e bëra publike për të gjitha çështjet materiale që lidhen me korporatën, përfshirë situatën financiare, performancën, pronësinë dhe qeverisjen e bankës, të jenë të sakta, të bëhen në kohën e duhur në një mënyrë lehtësisht të arritshme për palët e interesuara.
- Përgjegjshmëria: Drejtorët do të jenë përgjegjës për vendimet dhe veprimet e tyre ndaj aksionarëve, dhe, në raste të caktuara, ndaj palëve kryesore të interesit, duke iu nënshtruar vetë një kontrolli rigoroz.

Paanshmëria: Banka është e detyruar të mbrojë të drejtat e

aksionarëve dhe të sigurojë një trajtim të barabartë të të gjithë aksionarëve, përfshirë aksionarët me pakicë aksionesh.

- Përgjegjësia: Drejtuesit i kryejnë detyrat e tyre me ndershmëri, paanshmëri dhe integritet. Banka i njeh të drejtat e palëve të tjera të interesit siç janë të parashikuara në ligje dhe rregullore, si dhe inkurajon bashkëpunimin midis bankës dhe palëve të interesuara për krijimin e ndërmarrjeve të qëndrueshme dhe financiarisht të shëndosha.

Banka drejtohet dhe administrohet nga:

- Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve;
- Këshilli Drejtues;
- Drejtoria dhe
- Komiteti i Kontrollit

STRUKTURA E QEVERISJES SË PËRGJITHSHME

Në Bankë operojnë organet e mëposhtme të qeverisjes si dhe organe të tjera:

- Asambleja e përgjithshme, është organi më i lartë vendim-marrës i Bankës.

Ajo përfaqësohet dhe përbëhet nga aksionarët e Bankes që zotërojnë aksione me të drejtë vote. Vendimet e Asamblesë së Aksionarëve të marra në përputhje me ligjin janë të detyrueshme për të gjithë aksionarët, këshillin drejtues, drejtorinë dhe punonjësit, apo përfaqësuesit e Bankës. Asambleja e Aksionarëve vendos për çdo çështje nëpërmjet vendimeve të marra me shumicë të thjeshtë ose të cilësuar, siç përcaktohet në Statut ose në ligj. Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve duhet të mbahet të paktën një herë në vit, brenda gjashtë muajve pas mbylljes së vitit financiar, me qëllim që të diskutohen, shqyrtohen dhe miratohen raportet financiare të vitit të mëparshëm financiar.

Në rastin e çështjeve, që vendosen me shumicë të zakonshme, Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse janë të pranishëm ose të përfaqësuar aksionarët që zotërojnë më shumë se 30% (tridhjetë përqind) të aksioneve me të drejtë vote.

- Këshilli Drejtues është organ vendim-marrës dhe mbikëqyrës. Këshilli Drejtues është përgjegjës për drejtimin strategjik të bankës, udhëzimin dhe mbikëqyrjen e menaxhmentit.

Këshilli Drejtues përbëhet nga 7 (shtatë) anëtarë. Anëtarët e Drejtorisë mund të jenë anëtarë të Këshillit Drejtues, me kusht që numri i përgjithshëm i tyre të mos përbëjë shumicën e të gjithë anëtarëve të këshillit drejtues. Emërimi dhe shkarkimi i anëtarëve të Këshillit Drejtues bëhet nga Asambleja e Aksionarëve sipas dispozitave të Statutit. Këshilli Drejtues zgjedh nga anëtarët e tij një Kryetar dhe një Zëvendës Kryetar të cilët do të kryesojnë dhe drejtojnë diskutimet gjatë mbledhjeve të Këshillit Drejtues. Kryetari dhe Zv. Kryetari nuk mund të jenë njëkohësisht anëtarë të Drejtorisë.

Shumica e anëtarëve të Këshillit Drejtues duhet të jenë individë, të cilët në çastin e zgjedhjes dhe gjatë gjithë kohëzgjatjes së mandatit nuk janë të lidhur me marrëdhënie interesash private me bankën, aksionerët që konsiderohen për shkak të ligjit se ushtrojnë kontroll mbi bankën dhe as me drejtuesit e saj ekzekutivë. Anëtarët e Këshillit Drejtues ushtrojnë kompetencat për një periudhë jo më të gjatë se katër vjet. Anëtarët e Këshillit Drejtues mund të rizgjidhen.

Mbledhjet e Këshillit Drejtues do të mbahen të paktën 4 herë në vit, dhe do të konsiderohen të mbledhura rregullisht me një kuorum prej 5 anëtarësh.

- Drejtoria organizon dhe drejton në mënyrë të vazhdueshme veprimtarinë e bankës. Drejtoria përcakton dhe mund të delegojë detyrat tek personeli, si dhe mbikëqyr ushtrimin e përgjegjësisë të deleguara, në përputhje me politikën dhe procedurat e miratuara. Drejtoria ndërmerr masat e nevojshme për të monitoruar dhe administruar të gjitha rreziqet ndaj të cilave është e ekspozuar Banka, në përputhje me strategjitë e miratuara.

Drejtoria përbëhet nga Drejtori i Përgjithshëm dhe një Zëvendës Drejtor i Përgjithshëm. Drejtori i Përgjithshëm është dhe Kryetar i Asamblesë së Përgjithshme të Aksionareve. Posti i Drejtorit të Përgjithshëm do të ushtrohet nga persona të cilët janë miratuar paraprakisht nga Banka e Shqipërisë. Drejtori i Përgjithshëm i Bankës, mund të emërohet vetëm një individ i cili përmbush kushtet kualifikuese dhe nuk plotëson kushtet skualifikuese për drejtorët e përgjithshëm të parashikuara në Ligjin nr. 9662, datë 18.12.2006 “Mbi Bankat në Republikën e Shqipërisë”.

Drejtori i Përgjithshëm emërohet për një afat jo më të gjatë se 3 (tre) vjet me të drejtë rizgjedhjeje. Drejtori i Përgjithshëm përfaqëson ligjërisht Bankën. Këshilli Drejtues për çështje të vecanta mund të autorizojë përfaqësimin e Bankës nga dy anëtarët e Drejtorisë së bashku.

- Komiteti i Kontrollit: Banka kontrollohet nga Komiteti i Kontrollit. Komiteti i Kontrollit

përbëhet nga tre anëtarë, që emërohen nga Asambleja e Aksionarëve dhe ka këto detyra:

a) Kontrollon dhe mbikëqyr zbatimin e procedurave kontabël dhe të kontrollit të brendshëm të bankës, duke përfshirë edhe procedurat e vendosura nga Banka e Shqipërisë, kontrollon llogaritë bankare dhe regjistrimet përkatëse;

b) Shqyrton raportet e kontrollit të brendshëm dhe monitoron trajtimin e përfundimeve të dala nga këto raporte;

c) Propozon ekspertin kontabël të autorizuar dhe realizon komunikimin ndërmjet tij dhe kontrollit të brendshëm të Bankës;

d) Bën vlerësimin e situatës financiare të Bankës, bazuar në raportin e ekspertit kontabël të autorizuar;

e) Kontrollon përputhshmërinë e veprimtarisë së Bankës me aktet ligjore dhe nënligjore dhe njofton për përfundimet Këshillit Drejtues të Bankës;

f) I jep mendim Këshillit Drejtues të bankës për të gjitha problemet që i kërkojnë prej këtij të fundit;

g) Miraton raportet dhe deklaratat financiare të përgatitura nga banka, me qëllim publikimin e tyre.

Komiteti i Kontrollit mblidhet jo më pak se tre herë në vit, në mbledhje të zakonshme dhe sa herë thirret nga Këshilli Drejtues në mbledhje të jashtëzakonshme. Vendimet merren me shumicë votash të të gjithë anëtarëve. Abstenime nuk lejohen. Anëtarët e Komitetit të Kontrollit nuk

mund të jenë të punësuar si anëtar të Drejtorisë së Bankës. Anëtarët e Komitetit të Kontrollit mund të jenë anëtarë të Këshillit Drejtues. Anëtarët e Komitetit të Kontrollit janë administratore të bankës për të cilët kërkohet edhe miratimi paraprak i Bankës së Shqipërisë.

Administratoret e Bankës Credins sh.a. zgjidhen në përputhje me kriteret e përcaktuara në Politikën “Për përzgjedhjen, vlerësimin dhe shpërblimin e Administratorëve të Credins Bank”.

KRITERET E PËRZGJEDHJES DHE EMËRIMIT TË ADMINISTRATORËVE.

Pavarësisht tagrave që kanë organet drejtuese për emërimin e Administratorëve të Bankës, procesi i shqyrtimit të të gjithë kandidatëve për këto pozicione kryhet nga Këshilli Drejtues nëpërmjet Komitetit të Shpërblimeve dhe Emërimeve, organ i cili pas vlerësimit dhe intervistimit të Kandidatëve, jep rekomandimin pranë Këshillit Drejtues. Në përzgjedhjen e kandidatit për Administrator, KSHE në bashkëpunim me Departamentin e Burimeve Njerëzore.

Këshilli Drejtues duhet t'i kushtojë vëmendje ruajtjes së balancave të përgjithshme përsa i përket kompetencave, njohurive, eksperiencave, diversitetit dhe gjinisë. Objektivi i Këshillit është që shumica e anëtarëve të KD të përbëhet nga drejtorë joekzekutivë të pavarur, përfshirë kryetarin e këshillit dhe kryetarët e komiteve

kryesore të këshillit, të cilët duhet të kenë përvojë në sektorin bankar dhe/ ose financiar.

Përzgjedhja e administratorëve bëhet bazuar në:

- ◆ Diversitet;
- ◆ Integritet
- ◆ Kualifikime, kompetenca dhe meritokraci;
- ◆ Shmangien e konflikteve të interesit;

KOMITETET PER APROVIMIN E KREDIVE

Banka ka krijuar komitete në disa nivele për të shqyrtuar dhe aprovuar ekspozimet kreditore dhe çdo çeshtje lidhur me kreditimin.

Këto komitete përshkallëzohen nga departamenti i rrezikut, e deri në Këshillin Drejtues sipas shumave dhe profilin të rrezikut të kredimarrësit.

Çdo komitet është i formalizuar në aktet e brendshme rregullative.

KOMITETI I SHPERBLIMEVE DHE EMERIMEVE (KSHE)

Ka si qëllim të mbikqyri emërimet dhe sistemin e shpërblimeve dhe të rishikojë, vlerësojë dhe rekomandojë Bordin Drejtues mbi aprovimin e politikave dhe të emërimeve dhe shpërblimeve, praktikave, si dhe caktimin e Drejtuesve dhe shpërblimeve që sigurojnë kandidatet, duke marrë parasysh që kompensimet janë të përshtatshme dhe në linjë me:

- ◆ Objektivat strategjike të Bankës,
- ◆ Strategjitë afatgjatë të biznesit dhe riskut,
- ◆ Performancën dhe mjedisin e kontrollit,
- ◆ Pritshmëritë dhe kërkesat e rregulloreve.

Rishikon gjithashtu në emër të Bordit, kanidatët për anëtarë të Bordi apo anëtarë të Komiteteve të tjera, drejtues ekzekutiv apo menaxher të lartë të Bankës.

Komiteti i Shpërblimeve dhe Emërimeve (në vijim i quajtur KSHE) është krijuar me vendim të Këshillit Drejtues të Bankës. Anëtarët dhe kryetari i Komitetit emërohen nga Këshilli Drejtues. Vetëm Këshilli Drejtues mund t'i ndryshojë anëtarët e emëruar të komitetit në çdo kohë. Sidoqoftë, Këshilli duhet të rishikojë çdo vit përbërjen e komitetit. KSHE – ja përbëhet nga të paktën tre anëtarë, të cilët janë drejtorë jo ekzekutivë me të drejtë vote dhe sekretari i komitetit pa të drejtë vote. Numri i anëtarëve të komitetit duhet të jetë gjithmonë tek. Kryetari duhet të jetë drejtor jo ekzekutiv i pavarur. KSHE-ve do të mblidhet normalisht të paktën 4 (katër) herë në vit.

KOMITETI I AKTIV PASIVIT (ALCO)

Komiteti i menaxhimit të aktiv/ pasiveve (ALCO) është i krijuar me vendim të Këshillit Drejtues të Bankës. Anëtarët dhe Kryetari i Komitetit janë të emëruar nga Këshilli Drejtues për një periudhë të pacaktuar. Vetëm Këshilli Drejtues mund të anulojë ose të modifikojë këto emërime në çdo kohë.

Qëllimi kryesor i ALCO-s është të mbrojë kapitalin e Bankës dhe mënyrën e investimit të tij, me qëllim harmonizimin e aktiveve dhe pasiveve të Bankës duke konsideruar strukturën e çmimit (pricing structure) dhe të maturiteteve, në përputhje me ligjet respektive dhe rregulloret e brendshme. Komiteti ALCO mblidhet të paktën një herë në muaj si dhe sa herë kërkohet në aktet e brendshme rregullative. Kryetari i Komitetit mund të kërkojë mbledhje të jashtëzakonshme nëse e konsideron të nevojshme.

PËRBERJA DHE STRUKTURA

- ◆ ALCO është formuar nga të paktën gjashtë anëtarë me të drejtë vote dhe nga sekretarja pa të drejtë vote.

Anetareve ALCO-s me të drejtë vote janë:

- Drejtori i Përgjithshëm (Kryetar i Komitetit),
- Zv. Drejtorët e Përgjithshëm,
- Drejtori i Divizionit Financiar;
- Drejtori i Divizionit Operacional,
- Drejtori i Divizionit të Administrimit të Riskut,

- Drejtor i Divizionit të Zhvillimit të Biznesit

- ◆ Anëtarë i ALCO-s pa të drejtë vote është:

- Drejtor i Departamentit të Thesarit
- Sekretari i Komiteti

Sekretari i komitetit ALCO është punonjësi Bankës i emëruar nga Kryetari i komitetit ALCO.

Drejtori i Përgjithshëm është Kryetari i ALCO-s. Në mungesë të tij, Komiteti drejtohet nga Zv. Drejtori i Përgjithshëm.

KOMITETI I PRODUKTEVE DHE SHËRBIMEVE

Komiteti i Produkteve dhe Shërbimeve (në vijim KPSH) është i krijuar me vendim të Këshillit Drejtues të Bankës. Anëtarët dhe Kryetari i Komitetit janë të emëruar nga Këshilli Drejtues për një periudhë të pacaktuar.

Qëllimi kryesor i KPSH-s është miratimi i produkteve dhe shërbimeve të cilat do të gjenerojnë të ardhura për bankën, në përputhje me strategjinë dhe planin e zhvillimit të biznesit të miratuar nga Këshilli Drejtues i bankës, si edhe në përputhje me zhvillimet, kërkesat e tregut dhe të klientelës së synuar dhe modifikimi i atyre ekzistueseve.

PËRBERJA DHE STRUKTURA

KPSH është formuar nga të paktën 8 anëtarë me të drejtë vote dhe nga dy pa të drejtë vote. Anëtarët e KPSH me të drejtë vote janë:

- Drejtori i Përgjithshëm (Kryetar i Komitetit),
 - Zv. Drejtorët e Përgjithshëm,
 - Drejtori i Divizionit Financiar;
 - Drejtori i Divizionit Operacional,
 - Drejtori i Divizionit të Zhvillimit të Biznesit,
 - Drejtori i Divizionit të Administrimit të Riskut
- Drejtori i Departamentit Juridik,

Anëtarë të komitetit pa të drejtë vote janë:

- Drejtori i Departamentit Marketing,

- Sekretari i Komitetit

Në funksion të produktit/shërbimit të propozuar sipas rastit në komitet mund të ftohen pa të drejtë vote edhe:

a. Drejtori i Departamentit Operacional

b. Drejtori i Departamentit të Kartave etj.

Sekretari i KPSH është punonjësi Bankës i emëruar nga Kryetari i Komitetit.

Komiteti i KPSH-së mbidhet sa herë është e nevojshme, në përputhje me strategjinë e bankës dhe sipas parashikimeve në akte të brendshme rregullative të saj, si dhe sa herë kërkohet nga Kryetari i Komitetit.

KOMITETI DREJTUES I IT DHE PROJEKTEVE

Ka për qëllim të administrojë, rishikojë, mbikëqyrë dhe të vendosë përparësitë lidhur me projektet dhe iniciativave të IT-së në Bankën Credins nga pikëpamja ndër-funksionale.

Ai siguron dhe këshillon Menaxhmentin e Bankës për zbatimin me sukses të projekteve dhe iniciativave strategjike të IT-së në përputhje me Strategjinë e miratuar të Bankës.

Roli i komitetit drejtues te IT dhe projekteve është të mbikqyrë mbarëvajtjen e projekteve, të sigurojë mbështjen dhe orientimin e nevojshëm për arritjen e objektivave të tyre dhe përputhshmërinë me strategjinë e Bankës. Një rol tjetër i këtij komiteti është edhe mbikqyrja e aktivitetin të departamenti të IT.

KDITP është krijuar me vendim të Këshillit Drejtues të Bankës. Kryetari emërohet nga Këshilli Drejtues, ndërkohë që Zv. Kryetari dhe anëtarët e Komitetit emërohen nga Kryetari. Komiteti përbëhet nga 9 anëtarë me të drejtë vote. KDITP do të mblidhet sa herë është e nevojshme dhe ka kërkesa nga kryetari dhe/ose anëtarët.

Përbërja e KDITP-së do të jetë si më poshtë:

Drejtori i Përgjithshëm
Kryetar

Zv. Drejtori i Përgjithshëm
Zëvendës Kryetar

Drejtor i Divizionit të Administrimit të Riskut
Anëtar

Drejtor i Departamentit të Menaxhimit të Projekteve
Anëtar

Drejtor i Divizionit të Zhvillimit të Biznesit
Anëtar

Drejtor i Divizionit Operacional
Anëtar

Drejtor i Departamentit të IT
Anëtar

Drejtor i Divizionit të Financës
Anëtar

Përgjegjës i Sektorit të Sigurisë së Informacionit
Anëtar

KOMITETI I RISHIKIMIT TË POLITIKAVE DHE PROCEDURAVE

Është i krijuar me vendim të Këshillit Drejtues të Bankës. Anëtarët dhe Kryetari i Komitetit emërohen nga Këshilli Drejtues për një periudhë të pacaktuar.

Qëllimi kryesor i KPP-së është krijimi, miratimi apo modifikimi, në përputhje me kuadrin ligjor të jashtëm dhe atë rregullativ të brendshëm, i politikave, procedurave, rregulloreve, udhëzimeve, manualeve dhe metodologjive si dhe akteve të tjera rregullative të Bankës, për të siguruar që aktiviteti i brendshëm të jetë i rregulluar në të gjitha aspektet dhe në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

PËRBERJA DHE STRUKTURA

KPP është formuar nga të paktën pesë (5) anëtarë me të drejtë vote dhe sekretari pa të drejtë vote. Anëtarët e KPP me të drejtë vote janë:

- ◇ Drejtori i Përgjithshëm që është edhe Kryetar i Komitetit.
- ◇ Zëvendës Drejtorët e Përgjithshëm,
- ◇ Drejtori i Departamentit Juridik dhe
- ◇ Drejtori i Drejtorisë së perputhshmërisë dhe PPP.

Anëtarët e KPP-se pa të drejtë vote janë:

- ◇ Sekretari i Komiteti

Drejtori i Përgjithshëm është Kryetari i KPP-së. Në rast të barazimit të votave

gjatë votimit, vota kryetarit është vendimtare. KPP mblidhet sa herë kërkohet nga Kryetari i Komitetit, në përputhje me nevojat e Bankës dhe kërkesat e Këshillit Drejtues apo të ligjvënësit.

MENAXHIMI I RREZIKUT DHE KONTROLLI I BRENDSHËM

PARIMI KRYESOR

Këshilli Drejtues është përgjegjës për përcaktimin e natyrës dhe shtrirjes së rreziqeve kryesore që është i gatshëm të marrë përsipër për arritjen e objektivave të tij strategjikë. Këshilli Drejtues duhet të ketë sisteme të menaxhimit efektiv dhe të shëndoshë të rrezikut dhe kontrollit të brendshëm me kompetencë të mjaftueshme, gjendje, pavarësi, burime dhe qasje në bord.


PARIMI MBËSHTETËS

MENAXHIMI I RREZIKUT: Banka i kushton një rëndësi të madhe menaxhimit të rrezikut dhe Këshilli Drejtues ka për detyrë të sigurojë përdorimin e sistemeve të përshtatshme për administrimin e rrezikut. Ndër të tjera, këshilli drejtues (i) miraton procedurat për administrimin e rrezikut dhe siguron respektimin e këtyre procedurave; (ii) analizon, vlerëson dhe përmirëson vazhdimisht efektivitetin e procedurave të brendshme të administrimit të rrezikut; (iii) zhvillon stimujt e duhur për organet ekzekutive, departamentet dhe punonjësit për të aplikuar sistemet e kontrollit të brendshëm; [(iv) krijon një komitet të këshillit drejtues për administrimin e rrezikut kur është e nevojshme; dhe (v) siguron që banka të respektojë legjislacionin dhe dispozitat e statutit.

RRJETI I DEGËVE

59
DEGË

71
ATM



RAPORTI I AUDITOREVE

BANKA CREDINS SHA

Pasqyrat Financiare të Konsoliduara për vitin e mbyllur më

31 Dhjetor 2019

TABELA E PËRMBAJTJES

Raporti i Audituesit të Pavarur.....	i-iii
Pasqyra e konsoliduar e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse.....	1
Pasqyra e konsoliduar e pozicionit financiar.....	3
Pasqyra e konsoliduar e ndryshimit të kapitalit.....	4
Pasqyra e konsoliduar e fiksit të mjeteve monetare.....	5
1 Të përgjithshme.....	6
2 Bazat e përgjithshme.....	6
3 Të ardhura neto nga interesat.....	26
4 Të ardhura neto nga komisionet.....	26
5 Të ardhura të tjera, neto.....	26
6 Fitimje nga zhvlerësimi i instrumenteve financiare.....	27
7 Shpenzime Personeli.....	27
8 Shpenzime Administrative.....	27
9 Shpenzimi i tatimit mbi fitimin.....	28
10 Mjete monetare dhe ekuivalente me to.....	28
11 Shuma të kushtëzuara me Grupin Qendror.....	29
12 Hua dhe paratënie bankave dhe institucioneve financiare.....	30
13 Letra me vlerë me VDPFH (të mbajtura për tregtim).....	31
14 Letra me vlerë të investimit.....	32
15 Letra me vlerë të borshit me kostu të amortizuar.....	35
16 Investime në shoqëri të kontrolluara dhe pjesëmarrje.....	36
17 Qira financiare.....	37
18 Hua dhe paratënie klientëve.....	39
19 Preru të riposëduara.....	43
20 Aktive afatgjata materiale.....	44
21 Aktive jo-materiale.....	45
22 Aktive të drejtues-përdorim.....	45
23 Aktive të tjera.....	46
24 Aktive tatimore të shtyra.....	46
25 Detyrimet ndaj bankave dhe institucioneve financiare.....	46
26 Detyrimet ndaj klientëve.....	46
27 Huatë.....	47
28 Borzhi i varur.....	47
29 Detyrimet e qirase.....	48
30 Detyrimet të tjera.....	48
31 Provizionet.....	48
32 Kapitali aksionar.....	49
33 Prirja e kapitalit.....	50
34 Rezerva e përgjithshme.....	50
35 Analizë maturiteti për aktivet dhe detyrimet.....	50
36 Angazhime dhe detyrimet e kushtëzuara.....	51
37 Shënime për palet e lidhura.....	54
38 Administrimi i rreziqut financiar.....	55
39 Ngjarje pas datës së raportimit financiar.....	80

Raporti i Audituesit të Pavarur

Për: Akcionerët dhe Bordin Drejtues të Banka Credins Sh.a.

Opinion

Ne kemi auditar pasqyrat financiare të konsoliduara të Banka Credins Sh.a (në tej referuar si "Grupi"), të cilat përfaqësojnë pasqyrën e konsoliduar të pozicionit financiar me datë 31 dhjetor 2019, pasqyrën e konsoliduar të fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e konsoliduar të ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e konsoliduar të fluksëve monetare për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara, përfshirë një përmbledhje të polixave kontabel me të rendesishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Grupit me 31 dhjetor 2019 dhe performancën financiare dhe fluksin e parave për vitin që mbyllet në këtë datë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

baza për Opinion

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-te). Përgjegjësit tona sipas kësaj standarde janë përkrahur në mënyrë të detajuar në seksionin e raportit ku jepet Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Grupi në përputhje me Kodin e Etikës të Komablistëve Profesionistë të njohur nga Bordi Ndërkombëtar i Standarde të Etikës për Komablistët (IFSB), kështu etikë që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, si dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etikë në përputhje me kodin IFSB. Në besojmë se evidencat e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Përsosurve të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare Konsoliduara

Drejtimi është përgjegjës për përparësinë dhe pasqyrën e drejtë të pasqyrave financiare të konsoliduara në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF), dhe për ato kontrolle të brendshme që drejtimi gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përparësinë e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomalitë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përparësinë e pasqyrave financiare të konsoliduara, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Grupit për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështje që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimet kontabel të vlerësimit përveç se në rastin kur drejtimi synon të liqullojë Grupin ose të ndërprejë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternative tjera reale përveç se më sipër.

Ara që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqerjen e procesit të raportimit financiar të Grupit.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare Konsoliduara

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme jeh të një fakti nëse pasqyrat financiare të konsoliduara në tërësi nuk kanë anomalitë materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të leshojmë një raport auditimi që përfaqësojë opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA ve do të identifikojë gjithmonë një anomalitë materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijin si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, ato janë të mënyrës të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marrë bazuar në këto pasqyra financiare të konsoliduara.

Si pasë e një auditimi në përputhje me SNA te, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticismin profesional gjatë procesit të auditimit. Në gjuhësi:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomaliave materiale në pasqyrat financiare të konsoliduara, për shkak të gabimit ose mashtrimit, projektujmë dhe zbatojmë procedurat auditimi të cilat u përputhen me rrezikun, si edhe marrim evidencat auditimi të plota dhe të mjaftueshme për të krijuar bazat e opinionit tonë. Rreziku i moszbulimit të një gabimi material që vjen si rezultat i një mashtrimi, është më i lartë se ai që vjen nga një gabim, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrjen e shifrave falsifikuese, mosveprimin të qëllimshëm, keqkuptimet, ose shkelje të kontrolleve të brendshme.
- Marrim një kuptueshmëri të kontrollit të brendshëm në lidhje me auditimin, për të planifikuar procedurat të përshtatshme në varesi të rrethanave, dhe jo për të shpeshur një opinionin mbështetës në kontrolle të brendshme të Grupit.
- Vlerësojmë konformancën e polixave kontabel të përdorura dhe arsyetueshmërinë e vlerësimeve kontabel dhe informacioneve shpjeguese të bëra nga drejtimi.
- Konkludojmë mbi përdorimin e duhur të parimit kontabel të vlerësimit nga drejtimi si dhe, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, konkludojmë nëse ekziston një pasiguri materiale e lidhur me ngjarje ose kushte të cilat mund të sjellin dyshime në aftësinë e Grupit për të vazhduar në vijimësi. Nëse konkludojmë që ekziston një pasiguri materiale, ne duhet të tregojmë vëmendjen në raportin tonë të auditimit për informacionet shpjeguese përkatëse në pasqyrat financiare të konsoliduara ose, nëse këto informacione shpjeguese janë të pamjaftueshme, të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencat e auditimit të marra deri në ditën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet e ardhshme mund të jenë shkak që Grupit të ndalojë të vazhduar në vijimësi.

- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare të konsoliduara, përfshirë dhënat e informacioneve shpjeguese, dhe nëse pasqyrat financiare të konsoliduara përfaqësojnë transakcionet dhe ngjarjet në ato mënyrë që arrijnë paraqitje të drejta
- Marrim evidencë të rëndësishme të auditimit të dalura në lidhje me informacionin financiar të subjekteve ose akteve të biznesit brenda Grupit për të shprehur një opinion mbi pasqyrat financiare të konsoliduara. Në jermë përgjegjes për drejtuesin, mbikëqerjen dhe performancën e auditimit të Grupit. Në rastet e vetëm përgjegjësi për opinionin tonë të auditimit.


Në konvokojmë me ata të cilët janë të ngarkuar me qeverisjen, ndësishtveshjet e tjera, për qellimin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet e rëndësishme gjatë auditimit, përfshirë çdo mangësi të theksuar në kontrollin e brendshëm të cilat ne identifikojmë gjatë procesit të auditimit.

Grant Thornton sh.p.k.

Tirana, Shqipëri
18 qershor 2020

Medina Kodra, FCP

Kodra



Banka Credins sh.a.

Pasqyra e konsoliduar e fitimit ose humbjes Per vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019¹

	Shënime	Viti i mbyllur 31 dhjetor 2019 Lek '000	Viti i mbyllur 31 dhjetor 2018 Lek '000
Të ardhura nga interesat	3	8,873,051	8,935,503
Shpenzime për interesat	3	(2,338,991)	(2,090,784)
Të ardhura neto nga interesat	3	6,534,060	6,844,719
Të ardhura nga komisionet	4	1,131,895	941,562
Shpenzime për komisionet	4	(185,415)	(112,667)
Të ardhura neto nga komisionet	4	946,480	828,895
Shpenzime të tjera	5	(175,026)	(500,449)
Të ardhura të tjera (Humbja/fitimi nga kurset e këmbimit)	5	177,372	4,146,679
		597,444	(139,711)
Të ardhura të tjera bankare		599,790	3,506,519
Humbje nga zhvlerësimi i instrumenteve financiare	6	(2,517,839)	(5,208,830)
Humbje nga huatë e pambledhshme	17, 18	(3,452)	(1,180,714)
Zhvlerësimi i aktivave afatgjata materiale	20	(356,042)	(293,710)
Amortizimi i aktiveve afatgjata jomateriale	21	(34,065)	(29,577)
Amortizimi i te drejtave të përdorimit	22	(328,721)	-
Shpenzime personeli	7	(1,503,125)	(1,336,849)
Shpenzime të përgjithshme administrative	8	(2,113,999)	(2,435,012)
		(5,857,243)	(10,484,692)
Pjesa e humbjes së investimit në pjesëmarrje	16	(6,731)	(11,909)
Fitimi para tatimit		1,216,356	683,632
Shpenzime tatimi mbi fitimin	9	(223,619)	(327,671)
Tatim fitimi i shtyrë	24	-	29,173
Fitimi neto i periudhës		992,737	385,034

¹Shënimet 1 deri 38 në faqet 5 deri 38 janë pjesë integrale e kësaj pasqyre financiare të konsoliduar

Banka Credins sh.a.

Pasqyra e konsoliduar e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse

Per vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019²

Shënime	Viti i mbyllur 31 dhjetor 2019 Lek '000	Viti i mbyllur 31 dhjetor 2018 Lek '000
Fidmi neto i perludhës	992,737	385,034
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse <i>Investime në letra me vlerë me vlerë të drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse:</i>		
Rivlerësimi i aktiveve financiare	413,749	852,598
Efekt i tatimit fitimit	(62,062)	(127,890)
Fidmi neto për aktivet financiare me vlerë të drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse:	351,687	724,708
<i>Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për t'u riklasifikuar në fitim ose humbje në punëdhën pasardhëse:</i>	351,687	724,708
<i>Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin, pas tatimit fitimit</i>	351,687	724,708
Totali i të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pas tatimit mbi fitimin	1,344,424	1,109,742
Të atribuueshme për:		
Aksionarët e shoqërisë mëmë	1,348,580	1,108,703
Interesat jo-kontrollues	(4,156)	1,039
	1,344,424	1,109,742

Këto pasqyra financiare të konsoliduara janë miratuar nga Bordi Drejtues i Banka Credins sh.a më 19 mars 2019 dhe janë nënshkruar në emër të tij nga:

z. Maitin Konkuti
Drejtor i Përgjithshëm



zgj. Valentina Prodan
Drejtoresh Departamenti Finance - Kontabilitet

²Shënimet 1 deri 3B në faqet 5 deri 80 janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara.

Banka Credins sh.a.

Pasqyra e konsoliduar e pozicionit financiar

më 31 dhjetor 2019¹

Shënime	31 dhjetor 2019 '000 LEK	31 dhjetor 2018 '000 LEK
Aktivat		
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	10 24,169,118	33,222,241
Shuma të kushtëzuara me Bankën Qendrore Hua dhe paradhënie bankave dhe institucioneve financiare	11 13,821,709	12,214,431
Letra me vlerë të matura me VDPGHI (të mbajtura për tregtim)	12 189,558	242,300
Instrumenta borxhi të mbajtura me VDP të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse	13 713,228	1,085,425
Instrumenta borxhi të mbajtura me kosto të amortizueshme	14 49,754,301	43,796,570
Investime në pjesëmarrje dhe aksione	15 16,588,837	-
Emri i mirë	16 26,225	27,999
Emri i mirë	16 39,971	43,371
Qira financiare	17 1,254,506	1,114,561
Hua dhe paradhënie për klientët	18 101,462,951	93,125,375
Parapagun i tatimit mbi fitimin	19 109,484	19,080
Prona të riposduara	20 5,295,635	5,106,821
Aktive afatgjata materiale	21 3,267,856	3,076,280
Aktive afatgjata jomateriale	22 358,375	107,428
Aktive për të drejta - përdorim	23 2,971,714	-
Aktive të tjera	24 1,009,122	483,067
Të drejta latimore të shtyra	-	44,092
Totali i aktiveve	221,032,790	193,709,040
Detyrimet		
Detyrimet ndaj bankave dhe institucioneve financiare	25 4,003,507	4,058,161
Detyrimet ndaj klientëve	26 189,029,276	167,253,446
Tualë	27 259,061	175,923
Borxhi i varur	28 6,656,002	6,183,174
Detyrimet tatimore të shtyra	29 94,130	-
Detyrimet e quasë	30 3,030,853	-
Detyrimet të tjera	31 320,463	455,188
Provizione	32 5,350	58,844
Totali i detyrimeve	203,398,642	178,194,688
Kapitali		
Kapitali aksionar	33 9,611,068	8,505,811
Primi i aksioneve	34 3,094,785	3,143,693
Rezerva e përgjithshme	35 2,207,740	1,905,710
Rezerva e rivlerësimit të lotrave me vlerë të vlefshme për shitje	36 1,121,470	769,783
Fidmi të pasqepëmdara	37 966,122	1,178,900
Totali kapitalit të shoqërisë mëmë	17,601,185	15,503,897
Interesat jo-kontrollues ("JK")	38 32,963	10,457
Total kapitali	17,634,148	15,514,354
Totali detyrimeve dhe kapitalit aksionar	221,032,790	193,709,040

¹Shënimet 1 deri 3B në faqet 5 deri 80 janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara.

Banka Credins sh.a.

Pasqyra e konsoliduar e ndryshimit të kapitalit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019¹

	Kapitali akëionar	Primi i lidhur me aksionin	Rezervë e përgjithshme	Rezervë rëzuesimi	Fitim i pashpërndarë	Total	Interesi jo kontrollues	Total kapitali
	'000 LEK	'000 LEK	'000 LEK	'000 LEK	'000 LEK	'000 LEK	'000 LEK	'000 LEK
Gjendja më 1 janar 2019	8,083,240	3,112,906	1,846,347	46,076	2,293,334	16,180,902	9,479	16,190,381
Modifikime të ndryshimit të SNRF 9 (shënimi 2.5)	-	-	-	(463,145)	(463,145)	-	-	(463,145)
Gjendja më 1 janar e rishikuar me SNRF 9	8,083,240	3,112,906	1,646,347	45,075	1,830,189	14,717,757	9,479	14,727,236
Fitim i vërit	-	-	-	724,708	383,995	383,995	1,039	385,034
Shpenzime të tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-	724,708	-	724,708	-	724,708
Total - të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-	724,708	383,995	1,108,703	1,039	1,109,742
Përvetësimi i shtimit të pasqyësuesit (shënimi 32.34)	389,044	-	259,363	-	(648,407)	-	-	-
Udhëtimet	-	-	-	-	(389,044)	(389,044)	-	(389,044)
Emetimi i aksioneve të reja (shënimi 32)	33,527	30,787	-	-	64,314	64,314	-	64,314
Humbje e kontrollit në filial	-	-	-	-	-	-	(61)	(61)
Gjendja më 31 dhjetor 2019	8,605,811	3,143,693	1,905,710	789,783	4,178,900	15,603,897	10,457	15,614,354
Fitim i vërit	-	-	-	996,893	996,893	996,893	(4,156)	992,737
Shpenzime të tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-	351,667	-	351,667	-	351,667
Total - të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-	351,667	996,893	1,348,560	(4,156)	1,344,404
Përvetësimi i fitimit të pasqyësuesit (shënimi 32.34)	453,046	-	302,030	-	(755,076)	-	-	-
Dividentë	-	-	-	-	(453,046)	(453,046)	-	(453,046)
Emetimi i aksioneve të reja (shënimi 32)	652,211	551,062	-	-	1,203,273	1,203,273	-	1,203,273
Rifitimi i kontrolloit në filial	-	-	-	-	(1,549)	(1,549)	26,652	25,103
Gjendja më 31 dhjetor 2019	9,611,068	3,694,785	2,207,740	1,121,470	966,122	17,607,185	32,963	17,640,148

¹Shënimi 1 deri 38 në faqet 5 deri në 80 janë pjesë integrale e kësaj pasqyre financiare të konsoliduar.

Banka Credins sh.a.

Pasqyra e konsoliduar e fluksit të mjeteve monetare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019¹

	Shënime	Viti i mbyllur 31 dhjetor 2019	Viti i mbyllur 31 dhjetor 2018
		'000 LEK	'000 LEK
Aktivitetet operative			
Fitimi para tatimit		1,216,356	683,632
Rregullimet për		-	-
Amortizimin dhe zhvlerësimin	20,21	390,107	323,287
Aktivitet afatgjatë të ruajtjes së pasurisë së përdorimit	20	2,090	93,219
Aktivitet e të drejtës së përdorimit	22	(2,971,754)	-
Zhvlerësimi i mjeteve financiare	6	2,517,839	5,208,830
Humbje të tjera nga huatë e pambledhshme	17,18	3,452	(1,180,714)
Pjesë takuese e humbjes së investimit në pjesëmarrje	16	6,731	11,509
Zhvlerësimi i pronave të riposduara	19	62,263	194,488
Të ardhurat neto nga interesat	3	(6,534,060)	(6,844,719)
Efekt i kursit të këmbimit në borxhin e varur		(206,963)	(205,387)
Flukset e mjeteve monetare të përdorura në aktivitetet operative përpara ndryshimeve në kapitalin e punës		(5,513,899)	(1,715,655)
Ndryshimi në hua dhe paratë bankare	12	53,197	(20,426)
Ndryshimi në hua dhe paratë klientëve	18	(11,189,947)	(1,532,498)
Ndryshimi në qirë financiare	17	(139,945)	(50,058)
Ndryshimi në shumat e kushtëzuara me Bankën e Shqipërisë	11	(1,807,682)	(888,029)
Ndryshimi në pronat e riposduara	19	(251,077)	(537,135)
Ndryshimi në aktive të tjera	23	(544,466)	669,258
Ndryshimi në detyrimet ndaj bankave	25	(67,224)	(2,099,060)
Ndryshimi në detyrimet ndaj klientëve	26	21,570,991	15,813,036
Ndryshimi i detyrimit të qirave financiare	29	3,030,853	-
Ndryshimi në detyrime të tjera	30,31	(93,688)	(283,045)
Interesi i arkëtuar		8,962,875	10,596,792
Interesi i paguar		(2,092,380)	(1,720,897)
Tatim fitimi i paguar		(313,665)	(412,294)
Flukset monetare neto nga aktivitetet operative		11,823,743	17,820,089
Aktivitetet investuese			
Blerja e letrave me vlerë	13,14,15	(49,605,174)	(26,345,383)
Shitja e letrave me vlerë	13,14,15	18,404,062	5,793,969
Letra me vlerë të maturuara	13,14,15	9,691,747	8,314,212
Investime në filiale	16	(32,573)	(20,633)
Blerja e aktiveve afatgjatë materiale	20	(548,444)	(743,015)
Blerja e aktiveve afatgjatë pamateriale	21	(273,140)	(30,866)
Flukset monetare neto nga aktivitetet investuese		(22,363,522)	(15,031,716)
Aktivitetet financiare			
Fukse hyrëse nga borxhi i varur	28	1,357,029	548,091
Fukse dalëse të borxhit të varur	28	(703,779)	(413,540)
Pagosa të financimeve të reja	27	83,147	49,184
Emetimi i kapitalit		750,259	(714,474)
Flukset monetare neto nga aktivitetet financiare		1,486,656	(530,739)
Rritje në aktive monetare dhe ekuivalente me të		(9,063,123)	2,257,634
Aktive monetare dhe ekuivalente me të më 1 janar		33,222,241	30,964,607
Aktive monetare dhe ekuivalente me të, më 31 dhjetor		24,169,118	33,222,241

¹Shënimi 1 deri 38 në faqet 5 deri 80 janë pjesë integrale e kësaj pasqyre financiare të konsoliduar.

Banka Credins sh.a.

Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbylltur më 31 dhjetor 2019
(shuma në mijë Lekë, përveç kur është shprehur ndryshe)

1 Të përgjithshme

Banka Credins SH.A (këtuja e tutje "Grupi") është një institucion financiar Shqiptar i themeluar më 1 janar 2003 në bazë të ligjit rregulltar në Shqipëri dhe është licencuar nga Banka e Shqipërisë më datë 31 mars 2003 për të ushtruar aktivitetin e saj si bankë në të gjitha fushat e aktivitetit bankar në Shqipëri në përputhje me Ligjin nr. 8365 "Për Grupin në Republikën e Shqipërisë", miratuar në Korrik 1998. Grupi është gërbashkuar subjekti i Ligjit nr. 8299, miratuar në dhjetor 1997 "Mbi Bankën e Shqipërisë" (këtuja e tutje referuar si "Banka Qendrore")

Më 31 dhjetor 2019 Grupi ushtronte aktivitetin e tij nëpërmjet drejtoreve të përgjithshme të tij në Tiranë, 50 degëve në Tiranë, Durrës, Fier, Lezhë, Elbasan, Vlorë, Shkodër, Korçë, Shtyak, Shkollë, Kavajë, Lushnjë, Fushë Krujë, Kukës, Durrës, Ballsh, Berat dhe Peshkopi si dhe B.ogjenova në Tiranë, Shkodër dhe Durrës (31 dhjetor 2019: 50 degë dhe 8 agjencitë)

